



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

Inspektorati Qendror, përgjatë vitit 2024 kishte si objektiv parësor dhe gjithëpërfshirës reformën në fushën e inspektimeve për forcimin e kuadrit ligjor lidhur me përmirësimin e klimës ndaj biznesit duke synuar vendosjen e një kulture parandaluese dhe këshilluese për subjektet, krijimin e një sistemi meritokracie për rekrutimin dhe zhvillimin e karrierës së inspektorëve, përmirësimin e teknologjisë për të lehtësuar procesin e inspektimit online nëpërmjet sistemit unik të inspektimeve, si dhe vendosjen e një sistemi të qartë dhe efikas për trajtimin e ankesave dhe kontestimeve nga bizneset dhe individët në lidhje me veprimet inspektuese pa konflikt interesi, duke rritur kështu besimin për sistemin inspektues.

Miratimi i ligjit 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si ligj horizontal, rregullator, i cili normon procedurën e inspektimit për të gjitha inspektoratet në nivel qendror dhe vendor që janë në fushë zbatimit të tij, ka sjell si risi vendosjen e paralajmërimit si dënim administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit, sepse sa më të informuara të jenë bizneset për inspektimet dhe sa më transparente të jenë listat e verifikimit aq më shumë do të krijohen kushtet për të realizuar në mënyrë të rregullt aktivitete biznesi, me qëllim mbrojtjen e interesit publik.

Nga ndryshimet ligjore dhe organizative të disa inspektorateve shtetërore dhe strukturave të tjera inspektuese me fusha veprimtarie të përbashkëta apo të ngjashme dhe krijimi në një inspektorat të vetëm, të cilët tashmë do të përfshihen gjatë zbatimit të ligjit të ri për inspektimin, do të sigurojnë shmangien e mbivendosjes së kompetencave ligjore dhe rritjen cilësore të bashkërendimit të inspektimeve, si dhe lehtësimin e ngarkesave administrative të panevojshme ndaj biznesit.

Nga riorganizimi i inspektorateve dhe vendosja e një sistemi të qartë të inspektimeve në zbatim të ligjit nr. 99/2024 do të synohet të kemi përfitime në:

- ✓ krijimin e një sistemi inspektimesh me fokus këshillimin, parandalimin dhe koordinimin e inspektimeve me fusha të njëjta apo të përafërta inspektimi me bazë rrisht, për rritjen e efektivitet dhe përgjegjshmërisë në inspektime;
- ✓ përmirësimin e teknologjisë për optimizimin dhe lehtësimin e realizimit të procedurave online të unifikuara, të bazuara në të dhëna, prova dhe me metodologji të vlerësimit të rrishtit nëpërmjet aplikacionit mobile të inspektimit “*e-Inspektimi*”;
- ✓ rritjen e integritetit të trupave inspektuese për të qenë më profesionale, nëpërmjet një procesi rekrutimi të standardizuar, bazuar në sistemin e karrierës;
- ✓ vendosjen e një sistemi të qartë dhe efikas për trajtimin e ankesave ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit, pa konflikt interesi, si dhe qasjen e re për pjesëmarrje në komisionin e shqyrtimit të ankimit të një përfaqësuesi nga organizata joqeveritare me aktivitete në fushën e biznesit apo nga organet e përfaqësimit të biznesit;

- ✓ krijimin e një klime më të favorshme ndaj biznesit, për zhvillimin e konkurrencës së ndershme, si dhe garantimin e rregullave të njëjta në treg;
- ✓ rritjen e besimit tek qytetarët për funksionimin dhe zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin në nivel më të lartë të sigurisë dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

Inspektorati Qendror, me të gjitha këto ndryshime që priten të realizohen nga hyrja në fuqi dhe zbatimi i ligjit nr. 99/2024, synon përmbushjen e detyrimit ligjor dhe misionit në fushën e veprimtarive inspektuese, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies së veprimtarive inspektuese në Republikën e Shqipërisë, si dhe përmirësimin e performancës së trupave inspektuese, duke garantuar që inspektimet të kryhen në përputhje me kornizën ligjore, bazuar në një procedurë administrative të unifikuar inspektimi *online* me dokumente të standardizuara, programim, vlerësim risku dhe proporcionalitet, me qëllim përmirësimin e jetës, shëndetit dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Së fundmi, shpreh besimin se iniciativa për të krijuar një platformë të re me orientimin e trupave inspektuese dhe procesit inspektues drejt këshillimit dhe paralajmërimit të subjektit të inspektimit për vetërregullim dhe përmirësim të përputhshmërisë me ligjet dhe aktet nënligjore, si dhe implementimin dhe promovimin e kulturës parandaluese mbi atë ndëshkuese, do të sjellë përmbushjen e detyrimeve tona për inspektime të besueshme dhe në koherencë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ku vendi ynë është palë.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
SHKËLQIM HAJDARI**



TABELA E PËRMBAJTJES

Mesazhi i Inspektorit të Përgjithshëm.....	1
Legjenda e Institucioneve	4
I. Hyrje.....	5
II. Qëllimi.....	14
III. Metodologjia.....	14
IV. Veprimtaria Inspektoratit Qendror për Vitin 2024.....	15
V. Objektivat për Vitin 2025.....	16
VI. Raportimi i veprimtarisë së trupave inspektuese sipas ministrive të linjës.....	18
1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.....	18
2. Ministria e Mbrojtjes.....	19
2.1 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.....	19
3. Ministria e Brendshme	20
3.1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	20
4. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.....	25
4.1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	25
4.2. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	28
5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.....	32
5.1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.....	32
5.1.1. Drejtoria e Inspektimit të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve.....	33
5.1.2. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion.....	34
5.1.3. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike.....	34
5.1.4. Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare.....	34
5.1.5. Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes.....	35
5.1.6. Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit.....	36
5.2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.....	38
6. Ministria e Arsimit dhe Sportit.....	41
6.1. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.....	41
7. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	45
7.1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.....	45
7.2. Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës.....	48
7.3. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.....	51
8. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	52
8.1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.....	52
8.2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.....	56
8.3. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.....	59
9. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.....	61
9.1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit.....	62
9.2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit.....	64
9.3. Agjencia Kombëtare e Pyjeve.....	66
VII. Raportimi i Veprimtarisë për Inspektoratet Vendore.....	67
VIII. Raport Monitorimi i Buxhetit për Vitin 2024, Inspektorati Qendror.....	68
IX. Konkluzione.....	72
X. Rekomandime.....	75

Legjenda e Institucioneve

AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBPM	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKSEM	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
AKZM	Agjencia Kombëtare E Zonave të Mbrojtura
DINGN	Drejtoria e Inspektimit të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve
DIPIE	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike
DIPNP	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion
DSGIK	Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit e Impianteve Kombëtare
DTAM	Drejtoria e Trajtimin të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
DPI	Drejtoria e Pronësisë Intellektuale
DSHPA	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IQ	Inspektorati Qendror
ISHMT	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
OMP	Organizata e Menaxhimit të Peshkut
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZMR	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

I. HYRJE

Inspektorati Qendror, si institucioni kryesor në fushën e inspektimit, edhe për vitin 2024 ka ushtruar veprimtarinë e tij, në funksion të rritjes së përgjegjshmërisë, efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së veprimtarive inspektuese në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar që inspektimet të kryhen në përputhje me kornizën ligjore, bazuar në një procedurë administrative të unifikuar inspektimi *online* me dokumente të standardizuara, programim, vlerësim risku dhe proporcionalitet, me qëllim përmirësimin e jetës, shëndetit dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Inspektorati Qendror ndër vite, gjatë zbatimit të funksioneve të ngarkuara nga ligji nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duke bashkërenduar, mbikëqyrur dhe koordinuar veprimtarinë inspektuese ka hasur problematika, të cilat kanë sjell vështirësi në zbatimin e këtij ligji¹, kryesisht të lidhura me:

- ✓ Mbivendosje të kompetencave ligjore midis inspektorateve shtetërorë, gjë e cila ka sjellë mbingarkesë për bizneset dhe menaxhim jo efektiv të funksioneve inspektuese;
- ✓ Ekzistenca e një numri të madh institucionesh me funksione inspektuese, mospërcaktimi i një vije të qartë ndarëse të kompetencave dhe funksioneve të inspektimit, si edhe mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e inspektimit;
- ✓ Sistemi aktual i marrëdhënieve të punësimit është me dy standarde të ndryshme për inspektorët - sipas Kodit të Punës dhe statusit të nëpunësit civil, duke krijuar një mungesë kohezioni në mënyrën se si trajtohen inspektorët. Në të njëjtën kohë, ky sistem realizohet pjesërisht nga inspektoratet përkatëse ose Departamenti i Administratës Publike për pjesën e rekrutimit dhe nga Inspektorati Qendror për pjesën e trajnimit dhe testimit, duke sjellë një mungesë harmonizimi në praktikën më të mira për të siguruar profesionalizmin e trupës së inspektimit;
- ✓ Veprimtaria inspektuese aktualisht karakterizohet nga mungesa e transparencës dhe efikasitetit, duke lënë hapësira për praktika korruptive dhe një barrë të rëndë administrative mbi biznesin. Bizneset kanë paqartësi dhe mungesë informimi për përmbushjen e kërkesave ligjore;
- ✓ Ushtrimi i veprimtarisë inspektuese ndikohet nga mungesa e pavarësisë në vendimmarrje dhe nga ndikimi politik, që dëmton integritetin e proceseve inspektuese;
- ✓ Ka një mungesë të pavarësisë në komisionet e ankimimit të gjobave dhe masave administrative, të cilat janë ngritur pranë inspektorateve përkatëse dhe për pasojë vetëm 6% e vendimeve ankimohen. Ka nevojë për të siguruar më shumë pavarësi dhe transparencë në procesin e ankimimit;
- ✓ Sistemi aktual i inspektimeve vuan nga mungesa e një procesi të përzgjedhjes së subjekteve të inspektimit në bazë të riskut. Ekziston një praktikë e zgjedhjes së inspektimeve në mënyrë subjektive, e cila ofron mundësinë për abuzime dhe korrupsion. Nevojitet përmirësimi i planifikimit të inspektimeve me bazë riskun, duke kufizuar inspektimet e paplanifikuara;

¹ Problematika të evidentuara edhe sipas rekomandimit 1.1, nga raporti i KLSH.

- ✓ Ka një mungesë të vlerësimit të performancës së inspektorateve në lidhje me ndikimin që ata kanë në përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushat përkatëse. Kjo sjell nevojën për të përcaktuar metodologji specifike për matjen e performancës në bazë të ndikimit shoqëror që ka inspektimi përkatës; (siç mund të përmendim ulja e aksidenteve në punë, ulja e ndotjes mjedisore, etj.)
- ✓ Numër i lartë i inspektimeve, i shoqëruar nga një numër i lartë i inspektimeve të paplanifikuara në rreth 30%, të cilat sjellin një barrë të konsiderueshme tek biznesi;
- ✓ Mbikëqyrja e inspektimeve në Shqipëri është përqendruar pranë Inspektoratit Qendror, i cili nuk ka arritur të zhvillojë plotësisht autoritetin rregullator të nevojshëm. Si pasojë, inspektoratet janë të përballura me sfida si: profesionalizmi i ulët, konflikte administrative, dhe infrastrukturë jo e përshtatshme.

Për sa më sipër dhe për të analizuar situatën e inspektorateve në Shqipëri, u ngrit një grup pune në zbatim të Urdhrit nr. 242, datë 29.12.2023, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për riorganizimin e inspektorateve”. Grupi ndërinstitucional i punës, u mbështet nga grupi teknik ndërinstitucional i punës, i cili u kryesua nga Inspektorati Qendror dhe ky grup realizoi një analizë të kuadrit rregullator në fushën e inspektimeve, një mbledhje të të dhënave, një analizë krahasuese me modelet e shteteve të tjera, duke dalë në një raport me propozim konkret për reformën. Propozimi përfshinte hartimin e një projektligji të ri për inspektimin ku konsistonte në konsolidimin e inspektorateve aktuale në inspektorate qendrore me funksione të pastra inspektuese, të organizuara mbi bazën e fushave të riskut, të mbështetura në modelin bazë të OECD-së për inspektimet, dhe në modelin francez dhe holandez të konsolidimit të inspektorateve.

Hartimi i projektligjit të ri për inspektimin i është nënshtruar një procesi të gjatë të takimeve paraprake konsultative² dhe konsultimit publik me grupet e interesit, ku rolin kryesor e kanë pasur dhomat e biznesit³, rekomandim ky i lënë edhe në takimin me Ambasadorin e Përhershëm Fuqplotë të Shtetit të Japonisë në Tiranë, Z. Makoto Ito, për përfshirjen e vetë bizneseve në procesin e reformimit, me qëllim rritjen e transparencës, efikasitetin e punës së inspektorateve dhe uljen e barrës administrative ndaj biznesit. Hartimi i një ligji të ri për inspektimet është një nga komponentët e reformës në inspektime⁴, ku fillimisht janë realizuar me sukses 2 komponentë: digjitalizimi dhe standardizimi i inspektimeve. Reforma në inspektime është në linjë edhe me angazhimet e Qeverisë Shqiptare, në Samitin e Londrës (2016), për fushën e inspektimeve, që lidhen me implementimin e procedurave inspektuese të digjitalizuara, me sistem GPS, me dokumente standarde dhe listë-verifikimi të standardizuara dhe rritjen e ndërgjegjësimit për këto procedura të reja tek qytetarët dhe biznesi; prezantimi i inspektimeve të bazuara në risk, që janë të planifikuara dhe të implementuara bazuar në riskun e mbledhur nga sistemi i digjitalizuar; trajnimi dhe certifikimi i inspektorëve për procedurat e reja, kodin e etikës, konfliktin e interesit dhe rregulla të tjera të integritetit.

² Që prej vitit 2019;

³ Me qëllim vendosjen e një komunikimi të vazhdueshëm, si dhe rritjen e bashkëpunimit janë nënshkruar Memorandume Bashkëpunimi me Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Dhomën e;

⁴ Iniciuar që në vitin 2017;

Hartimi i ligjit të ri për inspektimin është bazuar në parimet e OECD, ku senior policy makers⁵ kanë qenë pjesë e këtij procesi që prej vitit 2019, si dhe *best practices* të vendeve anëtare të BE-së dhe konkretisht Franca, Sllovenia dhe Kroacia, me inspektoratet homologe të cilave janë zhvilluar takime dhe është mbajtur kontakt i vazhdueshëm ndërinstitucional. Fillimisht është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Inspektorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Inspektorit të Përgjithshëm të Administratës Franceze⁶ (IGA), përmes së cilës, në kuadër të reformës në inspektime, u vendos parimi i mbështetjes nga IGA Franceze, të transformimeve të nxitura nga reforma, suportin në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, evoluimin e statusit të inspektorit, trajnimin e stafit të inspektimit, etj. Rregullat e hollësishme për funksionimin e bashkëpunimit u përcaktuan në Memorandumin e Mirëkuptimit datë 01.02.2018.

Për të mbështetur hartimin e projektligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është bashkëpunuar edhe me përfaqësuesit e Shoqatave dhe Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë vendase e të huaja, si dhe është përdorur një asistencë teknike me ekspertë të UNDP. Në të njëjtën kohë janë përdorur gjetjet nga raporti “*The system of inspections: recommendations for improvement*”⁷, i vitit 2020, i përgatitur për Grupin e Punës të lidhur me Reformat Strukturore të Qeverisë Shqiptare.

Eksperienca ndërkombëtare është përfituar edhe nga realizimi i një vizite studimore në Ljubljana, Slloveni, ku u realizuan takime zyrtare me Këshillin e Inspektorateve të Sllovenisë dhe përfaqësues të inspektorateve kryesore, për të shkëmbyer informacione për eksperiencën sllovene në fushën e inspektimeve. Në vazhdim është zhvilluar një takim pune me Inspektoratin e Përgjithshëm të Kroacisë, ku janë diskutuar në detaje veçoritë e sistemit kroat të inspektimit. Me këtë qasje, grupi ndërinstitucional, si dhe grupi ndërinstitucional teknik, i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, finalizoi hartimin e projektligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me objektiv riorganizimin e trupave inspektuese qendrore (shtetërore), sipas fushave të inspektimit me funksione të ngjashme inspektuese, si dhe për një menaxhim dhe koordinim më të mirë të të gjithë inspektorateve shtetërore/vendore.

Hartimi i projektligjit ka kaluar përmes një dialogu të vazhdueshëm me përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tyre të varësisë, për diskutimin e problematikave dhe formulimin e parashikimeve të duhura ligjore.⁸

Për të adresuar këto problematika, është thelbësore të forcohet kuadri ligjor që të krijojë një sistem meritokracie për rekrutimin dhe zhvillimin e karrierës së inspektorëve. Kjo do të sigurojë zbatimin më të mirë të ligjit për inspektimin, do të eliminojë mbivendosjen e

⁵ Z. Daniel Trnka, Analist i Lartë i Politikave, OECD, ku së bashku me Z. Jean Pierre Dalle, Inspektor i Përgjithshëm i Administratës në Francë dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror, në vitin 2018, u prezantua reforma në inspektime; draftet e përgatitura fillimisht u shqyrtuan dhe u vlerësuan si një hap i rëndësishëm për të përmirësuar fushën e inspektimeve në Shqipëri;

⁶ Nr. 537 prot., datë 06.10.2017;

⁷ I mbështetur nga asistencë teknike e siguruar nga projekti “Support to the reform of subordinated institutions and agencies in Albania” – FWC SIEA 2018.

⁸ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/739>

kompetencave dhe do të ulë barrën administrative për bizneset, duke rritur efikasitetin dhe transparencën në sistemin inspektues të vendit.

Pas kalimit të këtyre fazave të përmendura në formë të përmbledhur dhe për të adresuar zgjidhjen e problematikave, ky projektligj u miratua me ligjin nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”⁹, si dhe hyn në fuqi me datë 13.05.2025. Ligji i ri për inspektimin është një ligj horizontal, rregullator, i cili normon procedurën e inspektimit për të gjitha inspektoratet në nivel qendror dhe vendor që janë në fushë zbatimin e tij, rekrutimin, disiplinën e inspektorëve dhe ankimin administrativ, me qëllim unifikimin dhe konsolidimin e veprimtarisë së sistemit të inspektimeve dhe përmirësimin e klimës ndaj biznesit.

Për veçse se sa parashtruam më sipër lidhur me reformën në inspektime, IQ për gjatë vitit 2024, ka vijuar bashkëpunimin me inspektoratet shtetërorë dhe trupat e tjera inspektuese me qëllim përmirësimin e procesit të kryerjes së inspektimeve online nëpërmjet sistemit unik “e-Inspektimi”, duke mundësuar programimin e inspektimeve, bazuar mbi vlerësimin e riskut, dokumentimin e veprimtarisë inspektuese, identifikimin e problematikave dhe adresimin për zgjidhjen e tyre, ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Për vitin 2024, kryen inspektime online 17 inspektorate shtetërorë sipas standardeve unifikuese të veprimtarisë së inspektimit.

Inspektorati Qendror, gjithashtu ka dhënë mbështetje metodologjike për inspektoratet shtetërorë dhe vendorë për përditësimin e dokumenteve standarde dhe listë-verifikimeve sipas formateve të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm, si dhe janë implementuar në sistemin “e-Inspektimi”, për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi për inspektimin.

Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërorë, në të cilat marrëdhënia e punësimit rregullohet sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet trajnimit dhe testimit fillestar/periodik, vlerësoi gjithsej 67 inspektorë, për testimet fillestare, me qëllim që të kemi inspektorë të kualifikuar për kryerjen e veprimtarisë inspektuese.

Në kuadër të përmirësimeve të vazhdueshme, për optimizimin dhe lehtësimin e realizimit të procedurave të inspektimit nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, janë trajnuar gjithsej 371 inspektorë/punonjës të inspektorateve shtetërore.

Me qëllim harmonizimin e plotë të projektakteve me legjislacionin e inspektimeve, IQ ka dhënë mendime dhe komente për nismat ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit¹⁰.

⁹ Botuar në fletoren zyrtare nr. 192, date, 13.11.2024

¹⁰ Konkretisht projektligjet “Për nënproduktet me origjinë shtazore”, “Për shëndetin e bimëve”, “Për shëndetin e kafshëve”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimorë parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe projektvendimet “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024-2030 dhe Planit të Veprimit”, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026, në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës”.

Janë trajtuar në kohë dhe me cilësi gjithsej 30 ankesa/kërkesa të individëve/subjekteve për shqyrtimin e procedurave inspektuese, denoncimeve të ndryshme apo dhënien e informacioneve.

Ka përditësuar Programin e Transparencës në përputhje me aktet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përgjatë vitit 2024, Inspektorati Qendror siguroi shpërndarjen e 10-pajisjeve tabletë për inspektoratet shtetërore për kryerjen e inspektimeve online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”.

Inspektorati Qendror, referuar kreut V, të vkm nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, ka përditësuar dhe mbajtur Regjistrin Kombëtar të inspektorëve në detyrë për inspektoratet shtetërore, bazuar kjo në listat dhe informacionin e përgjithshëm të dërguar nga inspektoratet shtetërore.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 10433/2011, gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, inspektori ka detyrim ligjor të identifikohet me kartën e inspektorit dhe gjatë këtij viti raportues, u pajisën me kartë inspektori 247-inspektorë.

Gjatë këtij viti u realizua edhe njoftimi i dokumenteve të inspektimit nëpërmjet sistemit “*e-albania*”, duke i siguruar subjektit të inspektimit njohjen menjëherë me aktet administrative të realizuara gjatë procesit të inspektimit. Gjithashtu, portali “*e-Inspektimi*”, siguroi edhe nënshkrimin elektronik për rolin kryeinspektor, i cili në procedurën e inspektimit nënshkruan vetëm aktin administrativ “Autorizim”, por në vijim të optimizimeve të sistemit “*e-Inspektimi*”, po vazhdohet puna për të siguruar edhe vulosjen elektronike të dokumenteve që gjenerohen nga roli kryeinspektor shtetëror/rajonar.

Mbështetje teknike dhe remote në kohë reale, për të gjithë trupat shtetërore inspektuese në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku përfshihen 17 inspektorate shtetërore, të përbëra nga 1.699 inspektorë për zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë kryerjes së inspektimit online nëpërmjet portalit “*e-Inspektimi*”.

Monitorimi dhe ofrimi i informacionit në kohe reale, nëpërmjet sistemit “GPS” të integruar në pajisjet tablet ku aksesohet aplikacioni mobile i sistemit “*e-Inspektimi*”, për vendodhjen e trupave inspektuese në terren gjatë inspektimit, si dhe gjurmimin e nënshkrimit të akteve inspektuese.

Është implementuar në sistemin “*e-Inspektimi*”, hapësira e nevojshme për konfigurimet dhe përlllogaritjet e faktorëve që ndikojnë në inspektimet me bazë risku sipas metodologjisë bazuar në Urdhrin nr. 6, datë 19.02.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.

Një nga faktorët që ndikojnë në inspektimet me bazë risku është Konfigurimi i Objekteve të Inspektimit, i cili shërben për hedhjen e të dhënave të riskut lidhur me listë verifikimet. (duke patur parasysh që pesha totale të jetë 1 dhe që të jetë vendosur pesha specifike për secilën pyetje sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut). Duke qenë se listat e verifikimit janë voluminoze në pyetje, dhe përcaktimi i vlerës së tyre shumë specifik në vlerësim, inspektoratet shtetërore janë në proces vlerësimi.


Me gjithë arritjet e deritanishme, sfida është zbatimi i ligjit të ri të inspektimit nr. 99/2024, i cili ka sjellë risi të reja për përmirësimin e procesit inspektues në tërësinë e komponentëve të tij, për të rritur besueshmërinë e publikut, uljen e korrupsionit dhe barrës administrative ndaj biznesit, si dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore inspektuese.

Inspektorati Qendror, përveç arritjeve të përmendura, konstatoi se procesi inspektues ka edhe disa problematika lidhur me:


- ✓ Inspektimin në fushën e menaxhimit dhe përdorimit të burimeve ujore, në zbatim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar mbetet problematikë që ka ndikuar në rritjen e barrës administrative ndaj subjektit, i cili është sanksionuar 2 herë me dënime administrative për të njëjtën shkelje/çështje nga inspektoratet të ndryshme dhe konkretisht, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Me qëllim bashkërendimin e tyre, me fokus të veçantë uljen e barrës administrative ndaj biznesit në veprimtaritë me objekt inspektimin mbi menaxhimin e integruar të burimeve ujore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 29/2024, “Për burimet ujore”, u miratua urdhri nr. 24, datë 7.07.2024, “Për koordinimin dhe bashkërendimin e inspektimeve në fushën e përdorimit dhe menaxhimit të burimeve ujore”;
- ✓ Mungesën e vullnetit institucional për kryerjen e inspektimeve *online*, nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”, për veprimtarinë inspektuese në pikat e kalimit kufitar të AKU, inspektimet në fushën e inspektimit të territorit dhe planifikimit, për IKMT, si dhe në fushën e veprimtarisë së veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve, për AKVMB;
- ✓ Vazhdon ende mungesa e hartimit të listë-verifikimeve për procedurën e asgjësimit dhe licencimit, si dhe nuk janë përditësuar listë-verifikimet për AKU, fusha e inspektimit të ushqimit me origjinë shtazore dhe jo shtazore, kërkesë e përsëritur nga ana e IQ dhe KLSH;
- ✓ Mos miratimin e planit vjetor të inspektimit nga Ministri i linjës brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin për inspektimin;
- ✓ Mosrealizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë inspektuese në të gjitha rastet me tabletë nga trupat inspektuese;
- ✓ Mospërputhjen e programeve të miratuara të inspektimit me ato të gjeneruara në sistem, duke sjellë mosrealizimin e numrit të inspektimeve të programuara;
- ✓ Mungesën e infrastrukturës për pajisje tablet, për t’iu siguruar njësive vendore instrumentet për ushtrimin e inspektimeve *online*;
- ✓ Ezaurimin e hapësirave të lira të portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, që prej 6 muajve të dytë të vitit 2023, duke ndikuar në performancë të ulët të infrastrukturës, si dhe duke sjellë si pasojë herë pas here bllokimin e sistemit dhe vështirësi në realizimin e procedurave të inspektimit *online*.

Inspektoratet shtetërore përgjatë vitit 2024, kanë kryer gjithsej 84160 inspektime online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, nga të cilat të programuara 66581 dhe jashtë programit 17579, kjo krahasuar me 2023 që janë 78966 inspektime nga të cilat 65722 janë të programuara dhe 13244 janë jashtë programit.

Në grafikun më poshtë paraqiten inspektimet e realizuara në vitin 2024 krahasuar me ato të realizuara në vitin 2023, ku vihet re një rritje e inspektimeve gjithsej prej 7 %, dhe rritje e inspektimeve të programuara me 2%, si dhe rritje e inspektimeve jashtë programit prej 25 %, për të gjitha inspektoratet shtetërore.




Aktiviteti inspektues i programuar dhe ai jashtë programit për vitin 2024, krahasuar me inspektimet e kryera në vitin 2023, paraqitet sipas grafikut më poshtë.




Masa Administrative Gjobë 2024


Për shkeljet e konstatuara, për vitin 2024 inspektoratet shtetërore kanë marrë gjithsej 1323 masa administrative “gjobë”, ndërsa për vitin 2023 janë marrë 1362 masa administrative gjobë, prandaj re një zbritje prej 39 masa “gjobë”, më pak, sipas paraqitjes grafike në vijim:



Në mënyrë grafike, pasqyrohen të dhënat mbi Vendimet Përfundimtare të Inspektimit, të marra me masë administrative gjobë për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023.



Por, përgjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023, vihet re një rritje e përdorimit të tabletës për kryerjen e inspektimeve online pranë dhe në prani të biznesit, e shprehur kjo sipas grafikës sa më poshtë.



II. QËLLIMI

Ky raport pasqyron në formë të përmbledhur funksionimin e sistemit të inspektimit në tërësinë e komponentëve të tij, nëpërmjet aktiviteteve të zhvilluara përgjatë vitit 2024 nga Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore. Raporti paraqet një panoramë të qartë lidhur me rritjen e performancës dhe transparencës së veprimtarive inspektuese, nëpërmjet vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore, bazuar në një procedurë administrative të unifikuar inspektimi online me dokumente të standardizuara, programim, vlerësim risku dhe proporcionalitet, me qëllim uljen e barrës administrative ndaj biznesit, përmirësimin e jetës, shëndetit dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

III. METODOLOGJIA

Inspektorati Qendror, në referencë të ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të pikës 4, kreu IX, të vkm nr. 696/2013, përgatit raportin e përgjithshëm vjetor të inspektimeve, në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale, duke siguruar mbledhjen e të dhënave të nxjerra nga sistemi “*e-Inspektimi*”, raportimin vjetor të vënë në dispozicion nga inspektoratet shtetërore, si dhe akteve të tjera administrative që rregullojnë procesin inspektues.

Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, realizohet nga nxjerrja e të dhënave për modulën e programimit, çështjeve të inspektimit, raporteve dhe statistikave të veprimtarisë inspektuese, regjistrin të gjobave, si dhe dokumente të tjera justifikuese të përdorura gjatë veprimtarisë inspektuese.

Të dhënat e analizuara janë marrë nga moduli “Raporte” dhe “Moduli i çështjeve të inspektimit”, me anë të filtrave “hapur nga” dhe “mbyllur deri”, për periudhën nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024.

Vlen të theksohet se në hartimin e këtij raporti një zë të rëndësishëm ka edhe informacioni i marrë nëpërmjet raportimit të veprimtarisë së inspektorateve shtetërore për vitin 2024, të paraqitura pranë Inspektoratit Qendror, ku është trajtuar materiali sipas problematikave të hasura, zgjidhjeve të dhëna, rezultateve të arritura, si dhe objektivat e tyre për të ardhmen.

Në vijim të këtij Raporti pasqyrohen në formë të përmbledhur, arritjet, problematikat, objektivat, për Inspektoratin Qendror, për inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese, konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese.

IV. VEPRIMTARIA E INSPEKTORATIT QENDROR PËR VITIN 2024

Inspektorati Qendror, si institucioni kryesor në fushën e inspektimit, edhe për vitin 2024, ka ushtruar veprimtarinë e tij për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese nëpërmjet aktiviteteve të zhvilluara duke synuar rritjen e performancës dhe transparencës së procesit inspektues, si dhe duke realizuar këto objektiva:

- ✓ Hartimi i dokumentit analitik dhe miratimi i ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- ✓ Kryerja e inspektimeve *online* nga 17 inspektorate shtetërore në sistemin elektronik “*e-Inspektimi*”, me program vjetor dhe mujor sipas zbatimit të legjislacionit në fuqi për inspektimin;
- ✓ Trajnimi për 371 inspektorë të inspektorateve shtetërore, në kuadër të përmirësimit për optimizimin dhe lehtësimin e realizimit të procedurave të inspektimit nëpërmjet portalit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Trajnimi i 99 inspektorëve vendorë për fushën e pyjeve të 26 bashkive, për kryerjen e inspektimeve online për fushën e pyjeve nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, me dokumente standarde të inspektimit dhe listë-verifikimi;
- ✓ Vlerësimi dhe testimi i aftësive profesionale për 67 inspektorë në kohë prove, ku marrëdhënia e punës rregullohet sipas Kodit të Punës (AKU-32; ISHSH-26; ISHTI-9);
- ✓ Mbështetja metodologjike për të gjitha inspektoratet shtetërore për përditësimin e listë-verifikimeve dhe dokumenteve standarde, në varësi të ndryshimeve ligjore;
- ✓ Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese *online* për të gjitha inspektoratet shtetërore, që kryejnë veprimtarinë inspektuese nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ku u identifikuan problematikat, si dhe u dhanë rekomandime për përmirësimin e procesit inspektues;
- ✓ Bashkërendimi i veprimtarisë inspektuese në tërësinë e komponentëve të saj, si dhe ka koordinuar planet mujore të inspektimit për IKMT dhe AKM, dhe për subjekte të përbashkëta inspektimi;
- ✓ Dhënia e mendimeve dhe komenteve për nismat ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit, me qëllim harmonizimin e kuadrit ligjor për inspektimet;
- ✓ Trajtimi në kohë dhe me cilësi i 30 ankesave/kërkesave të individëve/subjekteve për shqyrtimin e procedurave inspektuese apo denoncimeve të ndryshme;
- ✓ Përditësimi i Regjistrit Kombëtar të inspektorëve në detyrë për inspektoratet shtetërore dhe për inspektoratet vendore, bazuar kjo në lëvizjet e burimeve njerëzore inspektuese;
- ✓ Përditësimi i Programit të Transparencës në përputhje me aktet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- ✓ Pajisja e 247 inspektorëve shtetërore me kartë inspektori (AKU-31; ISHTI-14; ISHSH-32; ISHMT-63; ISHPSHSH-18; IKMT-19; AKM-12; AKAP-5; AKSEM-13; AKZM-30; AKB-6; AKBPM-2; ZMR-2);
- ✓ Përdorimi i sistemit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”, për 26 njësi të qeverisjes vendore me dokumente standarde dhe listë verifikimi për fushën e inspektimit në pyje;
- ✓ Sigurimi i 10 pajisjeve tabletë për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut për kryerjen e inspektimeve *online* nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”;

- ✓ Organizimi dhe zhvillimi i vizitës studimore në Ljublanë, Slloveni, ku janë kryer takime zyrtare me Këshillin e Inspektorateve të Sllovenisë dhe përfaqësues të inspektorateve kryesore, për të shkëmbyer informacione për eksperiencën sllovene në fushën e inspektimeve. Në vazhdim është zhvilluar takim pune me Inspektoratin e Përgjithshëm të Kroacisë, ku janë diskutuar në detaje veçoritë e sistemit kroat të inspektimit, si dhe është vijuar komunikimi ndër-institucional për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e inspektimit, është zhvilluar takim konsultativ me Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës. Nën frymën e bashkëpunimit dhe përfitimit të eksperiencës është mbajtur korrespondenca e vazhdueshme me ekspertë të OECD, me të cilët përgjatë vitit 2024 është organizuar dhe një takim konsultativ.

V. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

Inspektorati Qendror, për vitin 2025, nëpërmjet planit të punës, ka përcaktuar objektivat e tij, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e transparencës së procesit inspektues, inspektime me bazë risku, koordinimin, mbështetjen dhe sigurimin e infrastrukturës për kryerjen e inspektimeve online, mbikëqyrjen dhe dhënien rekomandimeve për problematikat e konstatuara gjatë procesit të inspektimit, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të trupave inspektuese dhe lehtësimin e barrës administrative ndaj biznesit.

Këto objektiva konsistojnë në:

- ✓ Hartimin e projektakteve nënligjore mbi funksionimin dhe organizimin e inspektorateve, për riorganizimin e inspektorateve, si dhe projektaktet e tjera në funksion të zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të shoqëruara me paketat ligjore përkatëse;
- ✓ Përgatitjen e materialit analitik dhe konsultimeve mbi hartimin e projektakteve nënligjore dhe paketave ligjore përkatëse (projektvendimet, raportet e vlerësimit të ndikimit, të konsultimeve dhe relacionet shpjeguese) dhe paraqitjen e tij për vendimmarrje;
- ✓ Hartimin e materialit analitik që analizon të gjitha kërkesat ligjore dhe teknike për zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit “*e-Inspektimi*”, si dhe paraqitjen për vendimmarrje të raportit përfundimtar me rekomandime dhe me propozime konkrete në funksion të zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 99/2024;
- ✓ Hartimin e projektakteve nënligjore për përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, të shoqëruar me paketat ligjore përkatëse;
- ✓ Orientimin e trupa inspektuese drejt këshillimit dhe paralajmërimit të subjekteve të inspektimit nën frymën dhe sipas parimeve të ligjit të ri të inspektimit;
- ✓ Mbështetjen nga ana metodologjike për të gjitha inspektoratet shtetërore për përshtatjen e dokumenteve standarde dhe përditësimin e listë-verifikimeve sipas përcaktimeve që normon ligji nr. 99/2024;
- ✓ Vënia në funksion e modulit të riskut, për të planifikuar veprimtarinë inspektuese të ISH-ve mbi bazë të vlerësimit të riskut;

- ✓ Vazhdimin e kryerjes së inspektimeve online nga të gjithë inspektoratet shtetërore në sistemin “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese për inspektoratet shtetërore/trupat inspektuese, për zbatimin e legjislacionit në fuqi për inspektimin;
- ✓ Trajnimin dhe testimin e Inspektorëve në detyrë për kryerjen e veprimtarisë inspektuese me integritet dhe profesionalizëm;
- ✓ Bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese dhe koordinimin e planeve mujore të inspektimit për të realizuar inspektime të përbashkëta;
- ✓ Integrimi, vulosja elektronike për rolet kryeinspektor shtetëror/rajonar, si dhe përshtatja e sistemit “*e-Inspektimi*”, për të pritur ankimet e subjekteve për vendimet përfundimtare të inspektimit nga portali “*e-Albania*”.
- ✓ Sigurimi i tabletave për inspektoratet shtetërore dhe vendore për kryerjen e inspektimeve *online* në sistemin “*e- Inspektimi*”;
- ✓ Mbështetjen dhe bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore për fillimin e procesit inspektues online, nëpërmjet sistemit të inspektimeve “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Trajtimi i kërkesave dhe ankesave me prioritet, në kohë dhe me cilësi;
- ✓ Rritjen e transparencës së procesit inspektues për të siguruar besueshmërinë e publikut, si dhe përmirësimin e marrëdhënieve të partneritetit me biznesin.

VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS KRYEMINISTRISË DHE MINISTRIVE TË LINJËS.

1. KRYEMINISTRIA

1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA)


Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është struktura përgjegjëse për sigurimin dhe zbatimin e legjislacionit arkivor në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë, 06.11.2003, “Për Arkivat”, dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

DPA, nëpërmjet trupës inspektuese vazhdon të mbledhë të dhëna arkivore për të gjitha subjektet shtetërore, që përbëjnë rrjetin arkivor kombëtar duke krijuar “Databazën me institucione fondkrijuese”, si një sistem mirëmenaxhimi, monitorimi dhe mbikëqyrës i veprimtarisë së tyre.

DPA, për vitin 2024, nga 420 subjekte shtetërore qendrore, rajonale e vendore, të planifikuara për inspektim, ka realizuar 366 inspektime, nga të cilat 338 inspektime me statusin mbyllur dhe 28 inspektime me statusin anuluar.

Janë marrë 4 masa administrative me “Gjobë”, për shkeljet ligjore të konstatuara dhe për moszbatim të detyrave të lëna. Numri i çështjeve me gjoba të ankimuara është 1, e cila është lenë në fuqi nga komisioni i ankimimit. Nga vlera totale e gjobave prej 282.675 lekë, janë arkëtuar 229.675 lekë.

Grafiku i inspektimeve të realizuara gjatë vitit 2024, krahasuar me vitin 2023



Arritjet: Përgjatë vitit 2024, DPA, vazhdon të realizojë gjithë veprimtarinë inspektuese online, në përputhje të plotë me ligjin nr. 10433/2011 dhe ligjin sektorial, nëpërmjet tabletave duke bërë të mundur gjurmueshmërinë e procesit të inspektimit, me njoftim paraprak ku bashkëlidhet dokumentacioni për marrjen e njoftimit paraprak të autorizimit nga subjekti i inspektuar. Po gjatë këtij vitit, pati përmirësime të ndjeshme dhe vlerësim maksimal për zbatimin e njëhësuar të legjislacionit arkivor nga institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, të cilat u inspektuan nga DPA.

Problematika: Nga mbikëqyrja online e veprimtarisë inspektuese është konstatuar se nuk pasqyrohet në sistem ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar), kjo për arsye të vakancës së pozicionit të punës jurist në strukturë.

Objektivat: Për vitin 2025, në bazë të programit vjetor të inspektimit është planifikuar kryerja e 420 inspektimeve në institucione (subjekte), nga të cilat 415 të programuara dhe 5 të paprogramuara, nga ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të kryhen online, me tableta, konform rregullave të miratuara në ligjin për inspektimin dhe ligjin sektorial.

2. MINISTRIA E MBROJTJES

2.1 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)


AKMC, ushtron funksionet e saj sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, ku kryen inspektimin për zbatimin e dispozitave të këtij ligji për mbrojtjen civile për institucionet dhe strukturat shtetërore, si dhe në subjektet private.

AKMC, ka mision kryesor krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë, si dhe për t’u rimëkëmbur nëpërmjet një sistemi efikas të saj.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Shkurt-Dhjetor 2024, AKMC ka kryer në total 26 inspektime, nga të cilat 22 me statusin mbyllur, 1 hapur, 3 të anuluar, si dhe janë marrë 14 masa administrative, ku nga këto 5 masa me gjobë.

Janë trajtuar nga komisioni i shqyrtimit të ankimit 3 gjoba, nga të cilat 1 është lënë në fuqi dhe është në proces ankimi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe 2-gjoba janë shfuqizuar, vlera në total e gjobave është 650.000 lekë dhe nuk janë arkëtuar për vitin 2024.

Grafiku më poshtë, pasqyron inspektimet e realizuara të AKMC-së, inspektimet në total, të programuara, riinspektimet dhe masat administrative gjobë”.



Trupa inspektuese ka marrë 14 masa administrative.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: AKMC realizon veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet tabletave. Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të inspektimeve dhe në Programet Mijore, ku për vitin 2024 ka programuar vetëm për muajt: shkurt, mars, maj, korrik, shtator, ndërsa për muajt janar, prill, qershor, gusht, tetor, nëntor dhe dhjetor nuk ka programuar asnjë inspektim; Njoftimi paraprak i Autorizimit nuk ngarkohet në sistemin “e-Inspektimi”, si pjesë e dokumentacionit ligjor të procedurës inspektuese; Nuk plotësohet rubrika e procesverbalit në lidhje me “Shpjegimet apo kontestimet e subjektit”, duke mos përcaktuar afatin për paraqitjen e shpjegimeve apo kontestimeve të subjektit objekt inspektimi; Listë verifikimi nuk plotësohet në të gjitha rubrikat e saj dhe nuk argumentohet arsyeja e mosplotësimit. Nuk ka të dhëna në sistem për ecurinë e masës administrative.

Arritjet: AKMC duke qenë se sektori i inspektimit formalizoi aktivitetin e inspektimit për një periudhë kohore prej 2 vite me parë, ka arritur të krijojë praktika të mira inspektimi duke inspektuar prefektura, bashki dhe subjekte private, për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen civile.

3. MINISTRIA E BRENDSHME

3.1 Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është institucion qëndror buxhetor publik, në varësi të Ministrisë së Brendshme. IKMT ushtron funksionin e saj në zbatim të ligjit nr. 9780, datë, 16.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundraligjshme”, i ndryshuar. Me ndryshimet e vkm nr. 502, datë, 13.09.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme” e ndryshuar,

është shtuar fusha e përgjegjësisë së saj në “*parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin/inspektimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji*”, vendim i cili është shfuqizuar nëpërmjet vkm nr. 604, datë 20.10.2021, që është tashmë në fuqi.

Misioni i IKMT është ruajtja dhe siguria e ndërtimeve në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionin në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në fushën e mjedisit, pyjeve, burimeve ujore dhe produkteve të ndërtimit, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizmit dhe subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative.

Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit, edhe gjatë vitit 2024 ka vijuar të mos kryejë inspektime online në sistemin “*e-Inspektimi*”, në kundërshtim me ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe me vkm nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, pavarësisht se IQ ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për këtë fushë inspektimi, Drejtoria vijon të përdorë dokumente të parashtypura me numër serial, në procedurat e inspektimeve.

Në mars 2024, IKMT i kërkoi AKSHI-t ngritjen e një sistemi të ri inspektimi, të ngjashëm me “*e-Inspektimi*”, për fushën e inspektimit të territorit dhe planifikimit dhe pyjeve. Inspektorati Qendror e ka konsideruar këtë iniciativë në kundërshtim me kuadrin ligjor, duke theksuar se ai ka përgjegjësinë ekskluzive për krijimin dhe administrimin e portalit unik të inspektimeve, siç përcaktohet në ligjin nr. 10433/2011 dhe vkm nr. 696/2013.

Drejtoritë e Inspektimit të Mjedisit, Ujërave dhe Pyjeve kanë kryer procedura inspektimi në sistemin online gjatë vitit 2024, ku inspektimet për pyjet janë zhvilluar në kuadër të ligjit për moratoriumin, për mjedisin ndaj subjekteve në paligjshmëri, dhe për ujërat sipas programeve përkatëse. Për shkak të mbivendosjes së kompetencave me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Inspektori i Përgjithshëm ka bashkërenduar procedurat e inspektimit për fushat e Mjedisit dhe Pyjeve përmes Udhëzimit nr. 17 prot., datë 20.04.2023, “Për bashkërendimin e funksioneve inspektuese në fushën e mbrojtjes së pyjeve” dhe Urdhrit nr. 23, datë 30.08.2023, “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese të mjedisit ndërmjet Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

Gjatë vitit 2024, IKMT ka paraqitur për mendim këshillimor vetëm programet mujore për periudhën mars-gusht dhe dhjetor nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, në përputhje me Urdhrin nr. 374, datë 30.08.2023, “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese të mjedisit ndërmjet Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”. Ndërkohë, për muajt janar-dhjetor, 12 DRIKMT, programet mujore të dakordësuara nga Inspektorati Qendror nuk janë hedhur apo gjeneruar në sistem, duke u realizuar jashtë programit të miratuar.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, Drejtoritë e Inspektimit të Mjedisit, Ujërave dhe Pyjeve, kanë marrë dakordësi nga Inspektorati Qendror, për 430 inspektime të programuara, ndërsa

në sistemin online janë kryer 936 inspektime total, nga të cilat 309 janë realizuar jashtë programit.

Sipas IKMT në total janë realizuar 7916 inspektime. Nga DRIKMT -të janë realizuar 6436 inspektime në territor, 2174 inspektime në fushën mjedis, ujëra, 1623 inspektime në pyje, 2151 inspektime janë realizuar në fushën e ndërtimit, 298 inspektime në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, si dhe 190 monitorime në shkolla.

Nga të dhënat e raportuara nga IKMT për vitin 2024, janë marrë gjithsej 447 masa administrative gjobë dhe me vlerë totale 1.210.964.269 lekë.

Këto gjoba janë trajtuar sa më poshtë:

- Ndërtimet e kundraligjshme janë marrë 285 gjoba, me vlerë gjithsej 1.011.664.269 lekë dhe arkëtuar 4.490.977 lekë. Amkimuar në gjykatë, 101 gjoba, të cilat janë në proces.
- Mjedis dhe Ujëra janë marrë 160 gjoba, me vlerë gjithsej 199.100.000 lekë dhe arkëtuar 22.2456.533 lekë. Amkimuar në KSHA, 107 gjoba, ku prej të cilave 86 lënë ne fuqi, 14 shfuqizuar dhe 7 ndryshuar masa administrative.
- Pyje marrë 2 gjoba, me vlerë gjithsej 200.000 lekë dhe arkëtuar 200.000 lekë.

Ndërsa në sistem online për DRIKMT regjistruhen 936 inspektime, ky mosrakordim (me 7916 inspektime), vjen si pasojë e kryerjes së procedurave nga IKMT me dokumente të parashtypura me nr. serial.

Muajt	Programuar miratuar	Jashtë programi		
		Realizuar (Mbyllur)	Jashtë programi	Realizuar jashtë programi
Janar	pa plan	35	35	100%
Shkurt	pa plan	130	130	100%
Mars	12	159	147	92%
Prill	18	86	68	79%
Maj	17	111	94	85%
Qershor	111	102	-9	-9%
Korrik	99	102	3	3%
Gusht	80	45	-35	-78%
Shtator	pa plan	43	43	100%
Tetor	pa plan	28	28	100%
Nëntor	pa plan	45	45	100%
Dhjetor	93	50	-43	-86%
Totali	430	936	506	54%

Sipas të dhënave tabelore vërehet se pjesa më e madhe e veprimtarisë inspektuese të IKMT nuk kryhet në sistemin unik të inspektimeve “*e-Inspektimi*”, por jashtë tij me dokumente të parashtypura me nr. serial, në kundërshtim me parashikimet në germën “gj” të neni 16(2), të ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore

që rrjedhin prej tij. Gjithashtu edhe pjesa tjetër e cila realizohet nëpërmjet sistemit ka nevojë që të zbatohet me nivel më të lartë përgjegjësie në përmbushje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për inspektimin.

Në sistemin online “e-Inspektimi”, IKMT për vitin 2024 shënohen *1022 rezultate* në sistemin “e-Inspektimi”, nga të cilat *936 janë çështje të mbyllura*, nga të cilat *163 çështje inspektimi me masë administrative gjobë¹¹* dhe *195 gjoba*.

Sipas raportimit të IKMT, ku përfshihet edhe Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, janë marrë këto vendime sipas ndarjes sa më poshtë:

- 427 Objekte/ndërtime të prishura, të cilat janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin/ vkm shpronësimi;
- 356 Vendim prishje/pezullim të objekteve të kundërligjshme/pezullimi të punimeve në ndërtim;
- 261 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje;
- 159 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e mjedisit/ujërave;
- 2 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën pyjeve;
- 6 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet e ndërtimit/burimet ujore;
- 19 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna ndaj Kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprime/mosveprimet e tyre.

Arritjet: Përveç, inspektimeve të realizuara në territor, në përputhje me përcaktimet ligjore sipas fushës së vet të përgjegjësisë, IKMT ka vijuar të ndërmarrë veprime në kuadër të zbatimit të Projektit Infrastrukturor “Unaza e madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri Shkozë, Segmenti rrugor “Thumanë – Vorë - Kashar”. Gjithashtu, edhe në kuadër të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregdetit perëndimor të Liqenit të Shkodrës”.

Gjatë vitit 2024, është forcuar zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e territorit, mjedisit, pyjeve dhe ujërave, duke intensifikuar parandalimin, zbulimin dhe goditjen e paligjshmërisë në ndërtim, shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe ndotjen e mjedisit.

Janë realizuar inspektime, duke përmirësuar mbikëqyrjen e subjekteve që operojnë në sektorin e materialeve të ndërtimit, shfrytëzimit të pyjeve dhe përdorimit të ujërave.

Një tjetër arritje e rëndësishme ka qenë thellimi i bashkëpunimit me Policinë e Shtetit, duke zbatuar Udhëzimin nr. 161, datë 23.06.2020, për veprimet e përbashkëta dhe Urdhrin ndërinstitucional nr. 1727, datë 26.11.2021, për monitorimin e avancuar të territorit dhe burimeve natyrore. IKMT ka kontribuar në hartimin e projektit teknik për përdorimin e informacionit satelitor, me synimin për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe fuqizimin e kontrollit mbi territorin, duke e bërë mbikëqyrjen më efektive dhe të qëndrueshme në të ardhmen.

¹¹ një çështje inspektimi mund të përmbajë më shumë se një masë administrative me gjobë

Objektivat për vitin 2025: IKMT synon forcimin e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit duke evidentuar dhe prishur ndërtimet pa leje, si dhe duke liruar hapësirat publike të zëna në mënyrë të paligjshme. Institucioni do të intensifikojë luftën kundër krimit mjedisor përmes masave administrative dhe bashkëpunimit ndërinstitutional për procedimin penal të shkelësve. Digjitalizimi dhe modernizimi i shërbimeve do të jenë prioritetë për monitorim më efektiv të territorit dhe për parandalimin e ndërtimeve të kundërligjshme. IKMT do të mbikëqyrë zbatimin e projekteve madhore infrastrukturore dhe do të rrisë efektivitetin e inspektimeve në zonat e mbrojtura, vijën bregdetare dhe infrastrukturën publike, duke zbatuar një politikë të tolerancës zero ndaj ndërtimeve të paligjshme dhe ndotësve të mjedisit.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: Gjatë vitit 2024, mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese të IKMT-së në sistemin unik të inspektimeve “e-Inspektimi”, evidentoi mangësi të rëndësishme në zbatimin e procedurave ligjore dhe përdorimin e teknologjisë për transparencë dhe monitorim. Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit vijon të mos kryejë inspektime në këtë sistem, duke operuar përmes dokumenteve të parashtypura, në kundërshtim me ligjin nr. 10433/2011 dhe aktet përkatëse nënligjore. Në shumicën e rasteve, procedurat e inspektimit realizohen nëpërmjet platformës web, ndërsa përdorimi i tabletave dhe aplikacionit mobile për regjistrimin në kohë reale mbetet i ulët, çka ndikon në transparencën e procesit inspektues. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në dokumentimin e autorizimeve të inspektimit, mungesën e nënshkrimeve elektronike të inspektorëve dhe përfaqësuesve të subjekteve, si dhe mosplotësimin e detajuar të dosjeve inspektuese në sistem, duke vështirësuar gjurmueshmërinë dhe vlerësimin e rezultateve të inspektimeve.

Problematikat: Problematikat kryesore të evidentuara gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë së IKMT-së në vitin 2024 lidhen me mungesën e harmonizimit të procedurave inspektuese dhe koordinimit institucional. Mbivendosja e kompetencave ndërmjet IKMT-së dhe inspektorateve të tjera, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka krijuar konfuzion në zbatimin e kontrolleve dhe ka ngarkuar me barrë shtesë bizneset. IKMT nuk ka hartuar ende një modul të trajnimit për inspektorët në fushat e mjedisit, ujërave dhe pyjeve, duke ndikuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrolleve. Gjithashtu, një problem i përsëritur është mungesa e dorëzimit të Programit Vjetor dhe të Programeve Mujore të Inspektimit pranë Inspektoratit Qendror, duke rezultuar në një numër të lartë inspektimesh të realizuara jashtë programit. Mospërdorimi i sistemit “e-Inspektimi” sipas standardeve ligjore ka sjellë pasaktësi në dokumentim, mungesë transparence dhe vështirësi në monitorimin e masave administrative. Ndërkohë, janë evidentuar gjithashtu raste ku procesverbalet e inspektimit mbahen jashtë afateve të përcaktuara në autorizime, nuk dokumentohen në dosjet përkatëse detyrimet e lëna nga inspektimi i mëparshëm dhe nuk zbatohen masat urgjente për rastet e bllokimit apo sekuestrimit, duke ndikuar negativisht në efikasitetin e veprimtarisë inspektuese.

4. MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kryen veprimtarinë e saj, përmes procesit të inspektimit, verifikimit të kërkesave ligjore për zbatimin e legjislacionit të punës dhe të shërbimeve shoqërore nga subjektet, në zbatim të ligji nr. 9634 /2006 “Për inspektimin në punë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për “shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”, aktualisht është në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është struktura përgjegjëse për të siguruar respektimin e kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe atë të shërbimeve shoqërore, si dhe për çdo funksion apo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për ISHPSHSH.


ISHPSHSH funksionin me Urdhrin nr. 156, datë 24.11.2020 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, e cila numëron gjithsej 165 pozicione pune. Operon me veprime inspektuese me staf prej 94 inspektorësh në terreni, 13 Sektorë Inspektimi, të cilat janë të organizuara në 6 Drejtori Rajonale. Me inspektorët e punës, ISHPSHSH mbulon me vizita inspektimi rreth 5% në vit të aktiviteteve ekonomike të deklaruar. Shqipëria sipas të dhënave të INSTAT (publikuar më 04.06.2024), numëron rreth 226.778 subjekte, ndër të cilat 96.440 janë fermerë të pajisur me NIPT, të cilët nuk janë në fokusin kryesor të inspektimit të punës, ku janë inspektuar 190.340 vende pune, ose marrëdhënie punësimi në 9.860 subjekte të inspektuara.

Informaliteti i shfaqur gjatë inspektimeve ka qenë me 2600 punëmarrës informal, 1.058 ose 32% më shumë se një vit më parë, për të cilët është formalizuar marrëdhënia e punësimit brenda procesit inspektues, përmes masave ligjore të marra nga inspektorët e punës, duke formalizuar 2575 punonjës. Janë konstatuar të punojnë 3952 punëmarrës pa kontrata individuale ose 58% më shumë se viti 2023. Rezultatet nga formalizimi i punëmarrësve informal përlllogariten rreth 28.536.000 lekë/muaj kontribut i shtuar në skemën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që krahasimisht me mesataren e tre viteve të fundit është 11.807.280 lekë më shumë vetëm në 1 muaj.

Gjatë vitit 2024, u lancua dhe pilotua sistemi MIRA - Matrica e Inteligjencës dhe Analizës së Riskut, një platformë e avancuar digjitale e mbështetur në teknologji të avancuar si: “Data Mining” dhe “Machine Learnig”, ku ka mundur automatizimin e procesit të vendimarrjes dhe atë të planifikimit në bazë të rrezikut të veprimtarisë inspektuese. Përdorimi i kësaj platforme ka sjellë një qasje të re në inspektimin e punës, ku teknikat e avancuara të Inteligjencës Artificiale, kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në planifikim të zgjuar dhe në dërgimin e inspektimit të punës në subjekte me risk potencial në mos zbatimin e dispozitave ligjore të legjislacionit të punës.

ISHPSHSH për vitin 2024, ka kryer 10683 inspektime gjithsej, nga të cilat 7927 të

programuara dhe 2756 jashtë programit (nga sistemi “e-Inspektimi”), të shpërndara si:



Për vitin 2024 janë depozituar 920 ankesa/kërkesa, ku 61 % e inspektimeve për ankesë në punë kanë shkuar me masa administrative.


Në vitin 2024, u regjistruan 233 raste aksidentesh në punë, për të cilat u hapën çështje inspektimi. Pas verifikimeve, 82.9% e tyre u klasifikuan si aksidente pune, ku rezultojnë të aksidentuar në punë 177 punëmarrës, nga të cilët 33 me pasojë humbjen e jetës.

Gjatë periudhës janar-dhjetor janë vendosur 210 gjoba me vlerë 53.770.000 lekë, për raste të evidentimit të shkeljeve të rënda, nga këto: 32 gjoba në inspekte të programuara; 25 gjoba në inspekte tematike; 69 gjoba për shkak aksidenti në punë; 80 gjoba për shkak ankese (denoncime nga të tretët); 4 gjoba në inspekte rastësore.

Në vitin 2024, janë vendosur 3.433 masa administrative, që përfaqësojnë rreth 35% të subjekteve të inspektuara, sipas shkeljeve ligjore të konstatuara, për të cilat është ndërhyrë me masat e nevojshme për t'u korrigjuar ato. Masa administrative janë vendosur për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, orëve të punës, pagave, etj. Në përqindje këto masa janë:

- ✓ 41% “Pezullim” për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës dhe sigurisë në punë;
- ✓ 53% “Paralajmërim”;
- ✓ 6% masa me “Gjobë”.

MASAT ADMINISTRATIVE



Në 2024, 21% e dënimeve me gjobë janë ankimuar administrativisht pranë Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së, pra, janë shqyrtuar 53 ankime ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit, nga të cilat, 46 vendime inspektimi janë lënë në fuqi, 7 vendime janë ndryshuar (në 6 vendimarrje kemi ndryshim të masës nga gjobë në paralajmërim dhe në 1 kemi ulje të vlerës së gjobës) dhe shfuqizime janë zero.

Nga 39 procese gjyqësore, 33 janë ankime ndaj vendimeve përfundimtare. Në 17 raste gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë, në 5 raste gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë që do të thotë që ISHPSHSH ka humbur procesin, 17 raste janë në gjykim.

Aktualisht, nga gjobat e vitit 2024, janë likuaduar 46 % e gjobave, me një vlerë prej 17.370.000 lekë, duke shënuar rritje nga viti 2023 ku likuidimi i gjobave ishte në masën e 41%.

Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror bazuar në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”. Ajo ka përgjegjësi të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke synuar që përmes kontrolleve të vazhdueshme të sigurojë garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror. Për vitin 2024, realizoi 122 kontrolle të Qendrave/Shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: ISHPSHSH hartoi program Vjetor Inspektimi për vitin 2024, sipas formatit të përcaktuar ligjor, brenda afatit ligjor të përcaktuar, sipas një metodologjie risku, nga sistemi MIRA nëpërmjet Inteligjencës Artificiale - Programet mujore të inspektimit, janë hartuar me subjekte inspektimi - ISHPSHSH, realizon procedurën e inspektimit online, me dokumente standarde dhe listë verifikimi, kryesisht me tabletë, por në disa rajone procedura e inspektimit është realizuar pa tabletë, kryesisht në Drejtorinë Rajonale Shkodër. Në Autorizimin e inspektimit, përshkrimi i objektit të inspektimit nuk bëhet i plotë, pasi nuk përshkruhet objekti i saktë i inspektimit - Vendimi Përfundimtar i

Inspektimit kur konstatohet shkelja e kërkesave ligjore, merret masë administrative, në përputhje me sistemin MIRA.

Arritjet: Automatizimi i procesit programimit të inspektimit, me metodat e Inteligjencës Artificiale, mundëson një bazë të përmirësuar të dhënash të cilat shërbejnë në identifikim të problematikave të zbatimit të dispozitave ligjore, apo në përcaktim të sektorëve/ çështjeve që kanë nevojë për ndërhyrje; rritja e numrit të punonjësve të formalizuar në marrëdhëniet e punësimit, brenda procesit inspektues, për të zvogëluar informalitetin e të gjitha llojeve, rritja e ndërgjegjësimit të punëdhënësve kundrejt detyrimeve ligjore, ku tashmë pjesë e njoftimeve bëhen jo vetëm aksidentet, por dhe incidentet në punë; janë informuar subjektet e reja të rregjistruara, mbi të drejtat dhe detyrimet e legjislacionit të punës në marrëveshje me QKB.

Problematikat: Problematika në zbatimin e kërkesave ligjore në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë; mungesa e informimit të punëmarrësve; ndërgjegjësimi i punëdhënësve në respektimin e të drejtave dhe detyrimeve mes palëve; mangësi për kontrollin në shërbimet e kujdesit shoqëror; kapacitete të paplotësuara të Drejtorisë së Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore.

Objektivat për vitin 2025: Fuqizimi, rritja e cilësisë dhe përmirësimi i efikasitetit të procesit të inspektimit nëpërmjet planifikimit të sistemit MIRA dhe monitorimit e raportimit; Vënia në efikasitet të plotë të sistemit MIRA për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së inspektimit dhe komunikimi i saj me sistemin “e-Inspektimi”; Promovimi i një kulture parandaluese për vende pune të sigurta, të shëndetshme dhe produktive, përmes rritjes së ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve; përmbushja e detyrimeve institucionale për raportim në kuadër të procesit të integritetit në BE, si dhe zbatimi i strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale; forcimi i integritetit, rritja e profesionalizmit dhe etikës institucionale në ISHPSHSH.

4.1 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)

ISHMT, ka si mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale.


ISHMT, ushtron funksionet e saj në zbatim të vkm-së nr. 36, datë 20.1.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të mbikëqyrjes së tregut”, i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore, duke inspektuar zbatimin e kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, mbrojtjes së pronësisë industriale, garantimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, të inspektimit metrologjik, të etiketimit për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, si dhe kontrollin e detergjenteve të vendosur në treg.

Trupa inspektuese e ISHMT ka aktualisht në përbërje 57 inspektorë, krahasuar me 60 inspektorë që duhet të ketë sipas strukturës së miratuar, sipas drejtorive: (36) Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve, (15) Drejtoria e Pronësisë Intelktuale dhe (6) Drejtoria Teknike.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024, ISHMT ka kryer në total 2983 inspektime nga të cilat 2796 inspektime të programuara dhe 187 jashtë programit mbi bazë ankese, sipas drejtorive:

- ✓ Mbikëqyrja e produkteve jo ushqimore 2233 inspektime, nga të cilat 2111 inspektime të programuara dhe 122 inspektime jashtë programit;
- ✓ Pronësia intelektuale 750 inspektime, nga të cilat 685 inspektime të programuara dhe 65 inspektime të paprogramuara, mbi bazë ankese.

Grafiku më poshtë, pasqyron inspektimet e realizuara sipas sektorëve të ISHMT-së, inspektimet e programuara në raport me inspektimet jashtë programit.



Trupa inspektuese ka marrë 109 masa administrative në total nga të cilat 5 paralajmërime, 101 gjoba dhe 3 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar 8684 produkte nga të cilat 118 kanë qenë jo në konformitet.

Komisioni i Ankimit të Gjobave ka shqyrtuar 45 vendime administrative të ankimuar, nga të cilat:

- ✓ 1 masë administrative (gjobë) është rrëzuar;
- ✓ 42 masa administrative (gjobë) janë lënë në fuqi;
- ✓ 2 masa administrative (gjobë) janë ndryshuar;

**52 masa rezultojnë të paankimuara dhe 9 masa të vendosura në 2024 kanë qenë pjesë e Komisionit të Ankimit në 2025.*

Në gjykatë janë ankimuar 18 vendime administrative, ku nga këto:

- ✓ 1 prej tyre është rrëzuar kërkesëpadia e subjektit ankimues;
- ✓ 1 prej tyre është pranuar kërkesëpadia kundër ISHMT-së;
- ✓ 16 çështje janë në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë/Lushnje;

Përgjatë vitit 2024, janë arkëtuar 66 masa administrative me një shumë prej 14,848,000 lekë, nga të cilat, 14 masa administrative janë të vendosura në 2024 dhe 52 masa të vendosura në vitet paraardhëse.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: ISHMT realizon veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet pajisjeve portabël laptop dhe tableta; Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të inspektimeve, për vitin 2024 dhe në Programet Mujore të hartuar me listë subjektsh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuar, por jo të hartuar me bazë risku; Konstatohet një numër i lartë i subjekteve të programuara të cilat janë në progres dhe të anulhuara; Inspektimet e ushtruara nga ISHMT kryen me Autorizim, por autorizimi nuk njoftohet paraprakisht subjektit të inspektimit përpara fillimit të veprimeve të inspektimit; Mosnjoftimi nuk motivohet; Dokumentet Standarde plotësohen në të gjitha fushat e tyre, por ka raste kur nuk detajohen gjetjet, konstatimet apo të pasqyrohen të gjitha veprimet e procedurës inspektuese; Çështjet e inspektimit, në disa raste nuk kanë të ngarkuara dokumentet justifikuese të marra gjatë procesit të inspektimit apo edhe dokumente të dorëzuara nga subjekti për të cilat hiqet shkëlja e konstatuar në vendimin përfundimtar; Dokumentet e veprimtarisë inspektuese të gjeneruara në sistem nuk janë të nënshkruara nga kryeinspektori, inspektorët apo subjekti i inspektimit, për inspektimet e realizuara nëpërmjet pajisjes laptop; Listë verifikimet e ISHMT, duhet të përditësohen sipas formatit standard të miratuar nga Inspektorati dhe gjithashtu duhet të riformulohen disa pyetje të listë verifikimeve në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut; Procedura inspektuese, në shumicën e rasteve, realizohet konform ligjit nr. 10433/2011, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

Arritjet: Ndikimi në uljen e mos-konformiteteve të produkteve joushqimore si dhe në respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2024; Hartimi i “Plani i informimit dhe këshillimit të subjekteve të inspektimit dhe konsumatorëve qershor-dhjetor 2024”, si dhe organizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere për qeset plastike mbajtëse dhe tregtimin e bukës dhe prodhimit të brumit; Publikimi i informacioneve mbi veprimtaritë kontrolluese të ISHMT, me të dhëna të dobishme për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë, duke rritur numrin total të vizitorëve me 39.2%; Informimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe informimin e operatorëve ekonomikë, për të respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara në legjislacionin aktual, për të ofruar në treg produkte të sigurta si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, nëpërmjet 10 aktiviteteve/fushata sensibilizuese; Hartimi i databazës ligjore të ISHMT, duke pasqyruar të

gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që janë në zbatimin e ISHMT, duke përfshirë dhe aktet e BE-së që përafrojnë; Hartimi i Urdhrit “Për unifikimin e praktikave të mbikëqyrjes së tregut dhe inspektimit”, i cili unifikon afatet për strukturat inspektuese të ISHMT në respektim të plotë të kuadrit ligjor dhe synon menaxhimin e sa më korrekt të procedurës administrative të inspektimit; Fuqizimi i ISHMT-së dhe rritja e kapaciteteve njerëzore, nëpërmjet 27 trajnimeve të stafit në fushën e mbikëqyrjes së tregut, të pronësisë intelektuale dhe burimeve njerëzore; Bërja pjesë e ISHMT në sistemin e shkëmbimit të informacionit të produkteve jo të sigurta, që njoftohen nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut të vendeve palë të Marrëveshjes Qendrore Europiane të Tregtisë së Lirë; Angazhimi i ISHMT në vitin 2024 edhe në raportimet për nënkapituj të veçantë të Kapitujve 15, 12, 27, 14, duke qenë pjesë e GPNIE, jo vetëm për raportimet për Kapitullin 1, 7 dhe 28; Fillimi i procedurës së aplikimit pranë AKSHI-t për ofrimin në portalin e-albania të shërbimit “Pajisja me Çertifikatë regjistrimi të ashensorit” e cila do të sjellë shkurtime të proceseve administrative dhe lehtësim për të gjithë palët e interesuar; Hartimi dhe miratimi i listë verifikimet për pajisjet e gazit dhe për enët e thjeshta nën presion, ku ISHMT nisi për herë të parë inspektimet për këto grup produkte; Nënshkrimi i 2 marrëveshjeve të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit; Përgatitja dhe miratimi i Rregullores së Komisionit të Ankimit; Realizimi i takimeve me Prefektët e Prefekturave të Beratit, Vlorës, Korçës, Kukës, Gjirokastrës, Fier, Dibër, Lezhë, Elbasan në kuadër të task-forcës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 35, datë 19.02.2024, "Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Task- Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme"; Përmirësimi i borxhit, si pasojë e metodës së përdorur “njoftim nëpërmjet e-mailit” për ndërgjegjësimin e subjekteve për pagimin e detyrimeve të pashlyera.

Problematikat: Mungesa e logjistikës konkretisht me automjete të transportit për trupat inspektuese në kryerjen e detyrave funksionale të institucionit, të cilat sjellin vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve, duke pasur në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale; Nevoja për ristrukturim të institucionit, pasi rritja e gamës së fushave të inspektimit, shton nevojën për shtimin e stafit, shtrirja e gjerë territoriale të ushtrimit të veprimtarisë së ISHMT-së e cila funksionon si Drejtori Qendrore dhe jo me Zyra Rajonale, si dhe shtimi i fluksit shumë të lartë të praktikave administrative që shtron nevojën për rritjen e numrit të juristëve në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse; Nevoja për përmirësime të legjislacionit në fushën e Mbikëqyrjes së Tregut dhe të Pronësisë Intelektuale, për ashensorët, për detergjentet, rishikimi i kuadrit ligjor për blerjet online, për pajisjet e aerosolit, për pronësinë intelektuale dhe për rregulloren e brendshme të ISHMT; Nevoja për trajnime dhe fushata sensibilizuese, ku zgjerimi i fushë veprimtarisë së ISHMT ka sjellë nevojën për trajnime të vazhdueshme për fusha të reja si për aeroplanët pa pilot, kimikatet, pajisjet aerosol, programet kompjuterike. Informimi i konsumatorëve dhe operatorëve ekonomik në lidhje me kërkesat ligjore që shtron legjislacioni dhe procesi i integritetit European kërkon ndërmarrje të fushatave sensibilizuese dhe informuese; Nevoja për ndryshime procedurale që duhet t'i nënshtrohen analizave laboratorike në laboratorë të huaj, duke patur në konsideratë që në Shqipëri ekziston vetëm një laborator i akredituar për analizat e tekstit dhe lëkurës, ndërsa për produkte të tjera që janë në fokusin e inspektimit të ISHMT-së si: lodra, detergjente,

produkte të kujdesit për fëmijë, etj., analizat duhet të kryhen në laboratore të akredituar të huaj; Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB, e cila sjell që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden nga inspektorët në adresat që ata kanë deklaruar në QKB.

Objektivat për vitin 2025: Kontrolli i respektimit të kriterëve ligjore duke kontrolluar grup-produktet si p.sh instrumentet matës ligjërish të kontrolluar, parapaketimi, dekodera, karikues, llamba, etj, regjistrimi i ashensorëve në ISHMT, produkte për të cilat deri tani, nuk ka patur veprimtari mbikëqyrëse si: kimikate, artikujt aerosol, enët e thjeshta nën presion, pajisjet e gazit, artikujt piroteknik, etj, si dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale; Zbatimi i procedurave të inspektimit me korrektësi, me tablet nga të gjithë inspektorët dhe me njoftim paraprak të subjektit, si dhe implementimi i programit i protokoll matjeve për parapaketimet në sistemin e-inspektimi duke evituar përdorimin e kiteve; Informimi i operatorëve ekonomikë për zbatimin e kriterëve ligjore mbi sigurinë e produkteve joushqimore si dhe mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale; si dhe informimi/ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi sigurinë e produkteve dhe mbi të drejtat e tyre si konsumator; Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore, me anë të trajnime të vazhdueshme të stafit për rritjen e shkallës së njohurive në fushat përkatëse; Bashkëpunimet ndërinstitucionale dhe Rajonale në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të pronësisë intelektuale; si dhe fuqizimi i bashkëpunimit të ISHMT-së me Autoritetet e Mbikëqyrjes së Tregut të vendeve të Rajonit për shkëmbim eksperience dhe të përvojave më të mira.

5. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

5.1 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)

ISHTI, është struktura përgjegjëse për garantimin e përmbushjes së kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sigurisë së punës së instalimeve nën presion, sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, si dhe sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë jo ushqimore, duke ushtruar veprimtarinë inspektuese në zbatim të vkm-së nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

ISHTI, realizon funksionin inspektues nëpërmjet katër drejtorive: Drejtorisë së Inspektimit të naftës e gazit dhe nënprodukteve (DINGN); Drejtorisë së inspektimit të pajisjeve nën presion (DIPNP); Drejtorisë së inspektimit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike dhe makinerive ngritëse (DIPIEMN) dhe Drejtorisë së sistemeve të gazifikimit dhe impianteve kombëtare (DSGIK).

ISHTI, kryen inspektime në fushat e inspektimit, si: Inspektimi i gazit dhe i naftës; Inspektimit i pajisjeve nën presion; Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike; Transmetim shpërndarje, tregtim, depozitim, ndërtim e operimin të infrastrukturës së gazit natyror.

Për vitin 2024, nga mbikëqyrja rezulton se ISHTI, ka planifikuar gjithsej 6.105 inspektime dhe ka realizuar gjithsej 6.747 inspektime online, prej të cilave 5.752 janë të programuara dhe 995 inspektime jashtë planit.


Gjatë Janar - Dhjetor 2024, janë vendosur në total 59 masa administrative:

- DINGN janë dhënë 18 masa administrative;
- DIPNP janë dhënë 2 masa administrative;
- DIPIEMN janë dhënë 39 masa administrative.

Nga 59 masa administrative me vlerë 35.150.000 lekë, ku 32 prej tyre nuk kanë ushtruar ankimim administrativ. Ndërsa 27 prej tyre janë shqyrtuar nga Komisioni i Ankimimit pranë ISHTI-it, ku 14 masa administrative janë shfuqizuar me vendim të Komisionit të Ankimeve me vlerë 9.500.000 lekë, pra vlerë për vitin ushtrimor është 25.650.000 lekë dhe vjelur 12 gjoba me vlerë 3.300.000 lekë, mbetën për tu arkëtuar 22.350.000 lekë.

Nga 45 masa administrative Gjoba, 6 masa administrative janë likuiduar vullnetarisht nga vetë subjektet kundërvajtës; 2 masa administrative janë ekzekutuar përmes zyrave përmbaremore; 8 masa administrative janë në proces ekzekutimi; 24 masa administrative sipas plotësimit të afateve ligjore janë dërguar në gjykatë për çeljen e Urdhrit të Ekzekutimit; 5 masa administrative janë në proces gjygjësor

Grafiku nr. 1. Totali i inspektimeve, masat administrative dhe ankimimet.



Drejtoria e Inspektimit të Naftës Gazit dhe Nënprodukteve (DINGN), kryen veprimtari inspektuese në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, duke garantuar kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës dhe gazit, si dhe nënprodukteve të tyre, për t’u siguruar konsumatorëve produkte cilësore.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ka realizuar në total 1020 inspektime, prej të cilave 861 inspektime të programuara dhe 159 inspektime jashtë planit. Trupa inspektuese e kësaj drejtorie ka vendosur në total 18 masa administrative “gjobë”.

Në territorin e vendit tonë për vitin 2024, kanë ushtruar veprimtari të tregtimit me shumicë në fushën hidrokarbure 142 shoqëri të tregtimit me shumicë, si dhe kanë ndërprerë aktivitetin e tregtimit me shumicë të hidrokarbureve shoqëritë: “Standart Oil” sha ; “FIA” sha ; “Ansoil” sha; “Pirro Oil” sha dhe “Toyota” sha. Gjithashtu, kanë mbyllur veprimtarinë e tregtimit me pakicë të karburanteve, 31 stacione shitje karburanti, nga të cilat 17 stacione në sektorin qendror, 11 stacione në sektorin jugor dhe 3 stacione në sektorin verior.

Janë marrë gjithsej 7237 mostra për kontroll cilësor para zhdoganimit 2.347.585 ton naftë dhe nënprodukte të saj, si dhe janë parashikuar 162.000.000 lekë të ardhura nga kontrolli cilësor në subjektet e tregtimit me shumicë, me pakicë dhe para zhdoganimit.

Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP), siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve nën presion përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 32, datë 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, janë realizuar në total 3187 inspektime nga ku 2912 inspektime brenda planit dhe 275 inspektime jashtë planit, si dhe janë vendosur 2 masa administrative “gjobë”.

Janë inspektuar në total 196 shkolla, 52 kopshte, 22 çerdhe, 10 konvikte, qendra kulturore, si dhe ka pasur 1551 pajisje të hequra, të ndaluara dhe çregjistruara, gjithashtu janë regjistruar 371 PNP të reja.

Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN), siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve elektrike përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me ligjin nr. 8734/2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

Për vitin 2024, janë realizuar në total 2611 inspektimi, ku prej të cilëve 2051 inspektime janë brenda planit dhe 560 inspektime jashtë programit, si dhe janë vendosur 39 masa administrative “gjobë”, me vlerë gjithsej 3.100.000 lekë, ku 34 prej tyre janë për mos realizim detyrash dhe 5 për refuzim të inspektimit nga subjektet.

Në zbatim të planit të masave për kontrollin në përmirësim të kërkesave sigurisë teknike, si dhe në mbështetje të mëtejshme të strategjisë kombëtare të turizmit janë realizuar 650 inspektime nga Ksamili në Velipojë në periudhën Shkurt-Qershor 2024, në *strukturat akomoduese turistike dhe inspektimi në institucionet arsimore publike dhe jo publike në Bashkinë Korçë, Maliq, Elbasan*. Janë identifikuar 500 subjekte të përbashkëta inspektimi që kanë në përdorim enë nën presion dhe janë konsumatorë të energjisë elektrike për të cilat në vijim inspektimi do të jetë i përbashkët nga të dyja drejtoritë DIPIEMN dhe DIPNP.

Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare, (DSGIK) ka si objekt inspektimin veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit. Objekti i inspektimeve teknike ka të bëjë me aspektet teknike të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të instalimeve dhe

pajisjeve që shërbejnë për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe терминаlet e gazit natyror të lëngëzuar.

DSKIG, për vitin 2024, ka kryer në total 7 inspektime nga ku 6 inspektime të programuara dhe 1 inspektim jashtë planit, si dhe nuk ka masa administrative. Gjithashtu është krijuar databazë e operatoreve ekonomik të licencuar nga ERE në fushën e operimit të gazit natyror dhe janë përgatitur programet e inspektimit për këta operatorë.

Momentalisht operatori kryesor dhe i vetëm që kryen aktivitet në fushën e gazit natyror është “Trans Adriatik Piperinë AG-Albania”, i cili kryen aktivitetin sipas licencës TGN 19, në stacionin e matjes në Bilisht dhe në stacionin e kompresorëve në Seman, Fier.

Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes (DTAM)

Me miratimin e strukturës dhe organikës së re të ISHTI-t me Urdhrin e Kryeministrit nr. 62 datë 19.04.2024, trajtimi i aksidenteve është krijuar Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes.

DTAM, ka si mision kryesor të punës së saj bashkërendimin dhe kontrollin e respektimit të rregullave, kritereve dhe kushteve teknike të sigurisë së jetës së njerëzve, mjedisit dhe vlerave materiale në rast aksidenti dhe raste të veçanta.

DTAM është organizuar në dy sektorë kryesorë:

1. **Spektori i Trajtimit të Aksidenteve**, ky sektor ka si detyrë kryesore trajtimin teknik të aksidenteve të ndodhura në fushat e veprimit të drejtorive inspektuese. Spektori i Trajtimit të Aksidenteve (S.T.A.), është përgjegjës për trajtimin e aksidenteve që ndodhin në fushat e mbuluar nga drejtoritë inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.
2. **Spektori i Mbikëqyrjes**, ky sektor mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e masave të sigurisë nga subjektet me risk të lartë, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin teknik dhe duke vlerësuar efektivitetin e masave parandaluese.

Gjatë periudhës Maj-Dhjetor 2024, Spektori i Trajtimit të Aksidenteve (STA) ka regjistruar gjithsej 39 aksidente, të cilat kanë pasur pasoja të rënda për jetën dhe pronën. Shpërndarja e aksidenteve sipas natyrës dhe pasojave është si vijon:

- 15 aksidente kanë përfunduar tragjikisht me humbje jete të qytetarëve dhe punonjësve;
- 4 aksidente kanë shkaktuar dëmtime fizike të konsiderueshme të qytetarët dhe punonjësit;
- 20 aksidente kanë rezultuar në dëme të mëdha materiale, duke prekur pronën private.

Drejtoria Inspektuese e Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse (DIPIEMN): Ka trajtuar 28 aksidente, të cilat përfshijnë aksidente të ndodhura në instalime elektrike, makineri ngritëse dhe pajisje të tjera industriale, që përbëjnë një nivel të lartë rrezikshmërie.

Drejtoria Inspektuese e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN): Ka regjistruar 3 aksidente, të cilat lidhen me rrjedhje, shpërthime ose incidente të tjera që përfshijnë naftën dhe nënproduktet e saj.

Drejtoria Inspektuese e Pajisjeve nën Presion (DIPNP): Ka trajtuar 8 aksidente, të cilat përfshijnë ngjarje në lidhje me pajisjet që operojnë nën presion.

Arritjet: Krijimi i një data bazë të të dhënave për trajtimin dhe menaxhimin e aksidenteve, me qëllim për të siguruar një proces efikas dhe të strukturuar për regjistrimin dhe ruajtjen e informacionit të lidhur me aksidentet; klasifikimi i aksidenteve; arkivimi i dokumentacionit; krijimi dhe përdorimi i manualit të trajtimit të aksidenteve etj.

Objektivat: Bashkëpunimi me Drejtorinë e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional, me qëllim ndërgjegjësimin publik mbi rreziqet teknike dhe shkaqet kryesore të aksidenteve; Sensibilizimi i Publikut; Përmirësimi i Imazhit Institucional; Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse; Bashkëpunimi me mediat lokale dhe kombëtare.

Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve

Drejtoria e Laboratorit Qendror, në aktivitetin e saj, ka si objektiv kryerjen me përgjegjësi të analizave laboratorike të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve, si dhe analizave të detergjentëve të ndryshëm, letrës, lëkurës dhe këpucëve në Laboratorin e Tekstilit. Në mënyrë të vazhdueshme janë ndërmarrë aktivitete që përmirësojnë efikasitetin dhe aktivitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Analizat kryhen në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare që mbulojnë fushën e shërbimit për testimin e kampioneve të marra në dogana, tregun e brendshëm dhe të tretë.

Gjatë vitit 2024 në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve u testuan gjithsej 7267 kampione, nga të cilat 3346 kampione të marra në dogana dhe 3921 kampione të marra për tregun e brendshëm, ku: 832 kampione janë sondazhe, 3042 kampione janë të plota dhe 47 kampione janë palë e tretë nga të cilat 17 kanë hyrë nga kodifikimi dhe 30 prej tyre nga zyra e protokollit. Nga analizimi i 11 kampionëve, përkatësisht 9 gazoil, 1 benzinë dhe 1 white spirit, kanë rezultuar me shmangie nga standardi gjatë vitit 2024.

Arritjet: Implementimi dhe zbatimi në mënyrë të vazhdueshme i të gjitha kërkesave të ISO 17025-2017, për të përmbushur të gjitha detyrat e një laboratorit të akredituar; përfundimi me sukses i vizitës vlerësuese të Laboratorit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit; përfundimi me sukses i procesit të mirëmbajtjes dhe kalibrimit të jashtëm të aparaturave; Pjesëmarrja në test krahasimi ndërkombëtar me Laborator të Akredituar Grek dhe vlerësimi maksimal për rezultatet nga analizimi i kryer i mostrës; trajnimi i stafit; blerja e aparatit të ri për analizimin e treguesve tek benzina; aplikimi për procedurën e riakreditimit nga DPA, të Laboratorit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve.

Objektivat: Ri akreditimi i Laboratorit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve; vendosja e sistemit të kondicionimit për të ruajtur mostrat në kushte optimale dhe ventilimit antizjarr në

ambientet e magazinimit të mostrave për largimin e avujve të krijuar nga qëndrimi i mostrave në këto ambiente; vendosja e detektorëve për tejkalimin e përqendrimit të nivelit të gazit dhe të avujve hidrokarbure të dëmshëm për shëndetin e personelit dhe eliminimin e ndonjë zjarri të mundshëm, detektorë zjarri dhe sistem fikje zjarri të menjëhershëm, detektorë për rrjedhje gazesh si helium, oksigjen dhe gaz i lëngshëm etj; blerja e aparateve të reja për shtimin e mëtejshëm të treguesve të analizuar, njohja dhe shfrytëzimi i literaturës së re si dhe metodikave bashkëkohore; Shërbimi i inspektimit të mirëmbajtjes, riparimit dhe kalibrimit pasi është një procedurë e pashmangshme dhe e domosdoshme për Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve dhe kriter i domosdoshëm për mbajtjen e titullit “Laborator i Akredituar”.

Laboratori i Tekstilit

Gjatë vitit 2024 në Laboratorin e Tekstilit janë kryer analiza dhe janë realizuar disa objektiva si: Implementimi i metodikave të reja; trajnimi i personelit me qëllim rritjen e cilësisë në kryerjen e analizave dhe përcaktimeve laboratorike, si dhe futjen e aparaturave të reja bashkëkohore në të ardhmen me qëllim rritjen e numrit të komponentëve të analizuar.

Për këtë periudhë pranë Laboratorit janë kryer kryesisht analiza detergjentesh të ndryshëm, solucione për larje dysHEMEJE, sapun likuid, larës rrobash, pastrues yndyrë, sapun rrobash, zbardhues, etj.

Arritjet: Nga mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese rezulton se procedura e inspektimit e ndjekur nga ISHTI, kryhet online me dokumente standarde dhe në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjet sektoriale; është finalizuar përditësimi dhe implementimi në sistemin “e-Inspektimi”, i listë verifikimeve, për të 3 drejtoritë; është realizuar kryerja e inspektimit për herë të parë për 650 *strukturat akomoduese turistike dhe inspektimi në institucionet arsimore publike dhe jo publike në Bashkinë Korçë, Maliq, Elbasan*; janë mbyllur veprimtaritë e tregtimit me pakicë të karburanteve 31 stacione shitje karburanti; identifikimi i 500 subjekteve të përbashkëta inspektimi që kanë në përdorim enë nën presion dhe janë konsumatorë të energjisë elektrike; janë përmirësuar normat, kushtet teknike dhe siguria e punës së pajisjeve në 64 Auto gaze, ku janë boshatisur, çmontuar dhe hequr Auto gazet mbitokësore të tregtimit të GLN-së dhe janë vendosur Auto gaze nëntokësore sipas normave e kushteve teknike.

Problematikat: Inspektorati Qendror, në zbatim të Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 06, datë 19.01.2021, “Për hartimin dhe miratimin e kërkesave specifike për arsimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore/vendore dhe strukturat e tjera inspektuese”, ka miratuar kriteret për arsimim, ku ISHTI për vitin 2024, nga 81 inspektorë gjithsej, ka pasur 6 raste punësimi ku nuk janë përputhur kriteret specifike të arsimimit, duke sjellë mos pajisjen e tyre me kartë inspektorit; Për sa i përket procesit inspektues online ISHTI, vazhdon të ketë mospërputhje të subjekteve të planifikuara për t’u inspektuar, sipas programeve mujore me subjektet e planifikuara dhe të gjeneruara në sistem për muajt përkatës; për inspektimet e programuara, nuk kryhet njoftimi paraprak i inspektimit jo më vonë se 7 ditë para fillimit të inspektimit; Për DINGN, inspektori/ët në periudhë prove mund të kryejë veprime inspektimi

vetëm nën mbikëqyrjen e një inspektori që ka kaluar testimin fillestar dhe të nënshkruajë çdo akt të tij, sipas nenit 22, të ligjit për inspektimin; Dokumentacioni i veprimtarisë inspektuese si: LV, PV dhe VP, duhet të plotësohen saktë dhe në të gjitha rubrikat e tij, si dhe të mbajë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit dhe gjetjet e tij; Para marrjes së vendimit përfundimtar të inspektimit inspektorët duhet të respektojnë afatet e subjektit për paraqitjen e kontestimeve apo shpjegimeve sipas pikës 4, të nenit 45, të ligjit për inspektimin; Ka nevojë për përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me rregullat e normave teknike për miratimin e standardit të gazit të lëngët dhe sigurinë nga rreziku elektrik; Përmirësimi i kushteve dhe mjeteve laboratorike në laboratorin Qendror; dixhitalizimi i arkivës së ISHTI-it; trajnimi i inspektorëve për ngritjen e nivelit profesional në lidhje me veprimtarinë inspektuese të tyre; mungesa e logjistikës (automjete, aparatura, ambiente).

Objektivat: Rritja e nivelit të respektimit të cilësisë sipas standardeve dhe rregullave teknike për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre në tregun e brendshëm; inspektime “Aksion Task Forcë me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë në qytetet turistike gjatë sezonit turistik; inspektime për kontrollet cilësore në të gjithë subjektet e tregimit me shumicë e pakicë, me qëllim që gjithë produktet që u ofrohen konsumatorëve të jenë konform standardeve të miratuara; vazhdimi i ecurisë së punës për krijimin e bazës së të dhënave për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike; përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me rregullat e normat teknike për miratimin e standardit të gazit të lëngët dhe sigurinë nga rreziku elektrik, si dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Akreditimi i statusit nga “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit”, për Laboratorin e tekstilit të ISHTI-t.

5.2 Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera kryen veprimtari në fushën e sigurisë në punë, të emergjencave dhe të shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike. AKSEM-i e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror, si person juridik publik, buxhetor. Ky institucion e zhvillon veprimtarinë inspektuese në bazë të ligjit nr. 135/2016, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike” dhe vkm nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar për sigurinë dhe emergjencat në miniera”, si dhe akte të tjera nënligjore në fuqi.


AKSEM, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, kryen inspektime në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në:

- ✓ Minierat nëntokësore me regjim gazi, të cilat inspektohen jo më pak se 3 (tre) herë në vit;
- ✓ Minierat nëntokësore pa regjim gazi dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, të cilat inspektohen jo më pak se 2 (dy) herë në vit;
- ✓ Minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve, të cilat inspektohen jo më pak se 1 (një) herë në vit.

AKSEM, gjithashtu monitoron e mbikëqyr galeritë e minierave të mbyllura dhe jashtë përdorimi, gatishmërinë e plotë të personelit, pajisjeve dhe mjeteve për të ndërhyrë e përballuar situatën për shpëtimin e njerëzve, vlerëson, mbyll dhe monitoron grykat e punimeve minerare në minierat e braktisura, regjistron çdo subjekt që kryen veprimtari minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike, vlerëson aftësitë teknike dhe profesionale të çdo personi fizik që kërkon të përdorë e të kryejë punë me lëndë plasëse në subjekte apo të punojë si specialist për emergjenca dhe shpëtim, kryen vlerësimin e projekteve teknike, me qëllim pajisjen e subjekteve me autorizimin e përdorimit civil të lëndëve plasëse, analizon dhe regjistron rastet e emergjencave dhe të aksidenteve të rënda me rrezik apo humbje jete... etj.

Trupa inspektuese e AKSEM, ka aktualisht në përbërje rreth 13 inspektorë në total, me profesion inxhinier.

Gjatë vitit 2024, AKSEM ka programuar 626¹² inspektime dhe ka realizuar 642 inspektime¹³, nga të cilat 622 inspektim janë të programuara dhe 20 inspektime jashtë programi, pra rreth 3 %.




Nga totali i inspektimeve të realizuara për vitin 2024, 20 inspektime janë realizuar jashtë programi. Në mënyrë grafike arsyet e inspektimeve jashtë programi, janë sa më poshtë.

¹² Referencë janë programet e sjella për mendim këshillimor dhe të gjeneruara në portalin unik të inspektimit “e-Inspektimi”;


¹³ Inspektime të cilat janë me statusin “Mbyllur”.

Inspektive jashtë programi 2024



AKSEM e realizon veprimtarinë e inspektimit në subjekte të cilat janë në sipërfaqe, në nëntokë si dhe subjekte me veprimtari të kombinuar në sipërfaqe dhe nëntokë.

Gjatë 2024, shpërndarja e inspektiveve sipas fushës së inspektimit është si mëposhtë:



Për vitin 2024, janë marrë 11 Vendime Përfundimtare të Inspektimit me masë administrative gjobë, nga të cilat 5 masa të marra në inspektive të programuara dhe 6 në inspektive jashtë programi, janë marrë 19 masa administrative Paralajmërim, si dhe 20 Vendime të Ndërmjetme për marrjen e masës urgjente.

Përsa i përket ecures së masës administrative, Komisioni i Shqyrtimit të Gjjobave ka shqyrtuar 2 Vendime Përfundimtarë Inspektimi, me masë administrative gjobë, të cilat i ka është lenë në fuqi.

AKSEM, ka marrë 11 masa administrative gjobë me vlerë totale 2.600.000 nga të cilat janë arkëtuar 3 gjoba me vlerë totale 950.000 lekë ose 36.5%, e vlerës.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: AKSEM e realizon veprimtarinë inspektuese online, kryesisht nëpërmjet pajisjeve tabletë. Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të Inspektimit për vitin 2024 dhe në programet mujore të hartuar me listë subjektsh inspektimi me bazë risku. Inspektimet realizohen kryesisht me autorizim i cili i njoftohet paraprakisht subjektit. Dokumentacioni i veprimtarisë inspektuese, në disa raste nuk plotësohet në të gjitha rubrikat përkatëse dhe në dosje nuk pasqyrohen të gjitha veprimet e procedurës inspektuese, me dokumentacion bashkëlidhur. Procedura inspektuese, në shumicën e rasteve, realizohet konform ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

Problematikat: Problematikat e hasura në subjektet minerare, janë problematika të cilat vazhdojnë ndër vite dhe sa po vinë e po thellohen akoma më shumë, si: Mungesa e fuqisë punëtore, një problem që konstatohet pothuajse në të gjitha subjektet minerare dhe sa vjen e po bëhet akoma më i mprehtë. Kjo ka sjellë mbylljen e disa subjekteve dhe reduktim të aktivitetit tek pjesa tjetër. Punëmarrësit janë të detyruar të punësojnë punonjës me moshë të madhe dhe pa eksperiencë pune në miniera, gjë që rrit riskun në punë.

Mungesa e drejtuesve teknik është përsëri një problem që po bëhet akoma më shumë i ndjeshëm. Mungesa e daljes së specialisteve të rinj nga universiteti politeknik, po sjell një perspektivë të zymtë për industrinë minerare në vendin tonë.

Pengesa që kanë shumë subjekte sipërfaqësore për fillimin apo vazhdimin e punimeve mbasi janë penguar prej strukturave të pushtetit vendor për heqjen e sipërfaqes së lejes së dhënë për shfrytëzim nga fondi pyjor e kullësor.

Objektivat: Për vitin 2025, nisur nga vështirësitë e hasura gjatë vitit 2024 dhe për të parandaluar e minimizuar rreziqet në veprimtarinë inspektuese, prioritet i punës së AKSEM do të jenë kontrollat e vazhdueshme në subjektet me regjim gazi sidomos subjekti "Albchrome" shpk, i cili aktualisht ndodhet në një situatë delikate që kërkon monitorim të rreptë të gjendjes së atmosferës minerare për shmangien e ngjarjeve të rënda. Gjithashtu, nuk do të lihen mbas dore edhe subjektet e tjera nëntokësorë duke ushtruar kontrollat e planifikuara në mënyrë rigoroze sipas programit të miratuar.

6. MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

6.1. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)

AKAP, ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

AKAP, ushtron veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vkm nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Para universitar”, i ndryshuar, me vkm nr. 129, datë 6.3.2024, “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, miratuar me Urdhrin nr. 254, datë 30.04.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe akteve ligjore dhe nënligjore që i përkasin fushës së arsimit parauniversitar.

Sipas strukturës të AKAP numri i punonjësve në fushën e inspektimit/monitorimit/vlerësimit në total është 66, ndërsa trupa inspektuese ka në përbërje 37 inspektorë, dhe marrëdhëniet e punës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.


AKAP për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024 ka programuar 331 inspektime, nga mbikëqyrja rezulton se për këtë periudhë AKAP ka kryer në total 323 inspektime nga të cilat 271 inspektime të programuara dhe 52 jashtë programit (për respektim të kërkesave ligjore dhe mbi bazë ankese, nga nxënës, mësues, prindër ose qytetar).



Nga 5 fushat për të cilat AKAP është përgjegjëse për realizimin e veprimtarisë inspektuese, gjatë vitit 2024, janë realizuar inspektime vetëm në 4 fusha, Inspektimi në Arsimin Parashkollor (Kopshtet), Inspektimi në Arsimin Bazë (arsimi fillor dhe arsimi i mesëm, i ulët), Inspektimi në Arsimin e Mesëm të Lartë, Inspektim për pajtueshmërinë e veprimtarisë së ZVAP me aktet ligjore dhe nënligjore. Në fushën Inspektim në Drejtorinë Arsimore Rajonale, nuk është realizuar asnjë inspektim, për vitin 2024.

Grafiku më poshtë, pasqyron inspektimet e realizuara, nga çdo Drejtori Rajonale, sipas fushave të inspektimit.


Inspektime të realizuara për çdo fushë nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale



Masat Administrative

Për vitin 2024, trupa inspektuese pranë AKAP ka marrë në total, 61 Vendime Përfundimtare Inspektimi me masa administrative, nga të cilat 50 masa administrative Gjjobë, me vlerë totale 7.310.000 lekë, si dhe 11 masa administrative Paralajmërim.

Masa Administrative Gjjobë 2024



Krahasuar me vitin e kaluar, kemi një ulje të numrit të gjobave, pasi për vitin 2023, janë marrë 60 masa administrative gjobë me vlerën totale 60.000.000 lekë.

Gjithashtu janë marrë 5 dënime plotësuese, “ndërprerje e menjëhershme të veprimtarisë”, ndaj subjekteve private që kanë ushtruar veprimtarinë pa licencë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit ka shqyrtuar 7 vendime administrative të ankimuar, nga të cilat: 6 masa administrative (gjobë) janë lënë në fuqi dhe 1 masë administrative (paralajmërim) është shfuqizuar, ndërsa në gjykatë janë ankimuar 2 vendime administrative nga subjekte private dhe aktualisht janë në proces gjyqësor.

Për vitin 2024, janë arkëtuar nga gjobat, të ardhura në buxhet në shumën 660.000 lekë, ndërsa për vitin 2023 nuk është arkëtuar asnjë gjobë.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: AKAP, realizon veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjin sektorial, me dokumentacion standard, online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, me tabletë; Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të inspektimeve dhe në Programet Mujore të hartuar me listë subjektsh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuar, por jo të hartuar me bazë risku; Inspektimet e ushtruara nga AKAP kryen me Autorizim, por njoftimi paraprak subjektit të inspektimit përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, nuk dokumentohet në dosjen elektronike, si dhe rastet kur autorizimi është i panënshkruar dhe vulosur nuk dokumentohet akti i nënshkruar dhe vulosur; Në rastet e inspektimeve jashtë programi, nuk argumentohet në autorizim dhe nuk dokumentohet bashkëlidhur, arsyeja e realizimit të kësaj procedure; Listë verifikimet kanë nevojë për riformulim të pyetjeve ku përgjigjet duhet të jenë sipas standardit Po/Jo/NA të jenë në përputhshmëri me kërkesën ligjore; Shpesh herë në procesverbal nuk detajohen gjetjet, konstatimet, nuk përcaktohet afati për paraqitjen e shpjegimeve apo të kontestimeve të subjektit objekt inspektimi.

Arritjet: Realizimi i veprimtarisë inspektuese online në portalin “e-Inspektimi”, nëpërmjet pajisjeve portabelë me dokumente standard.

Këshillime: Gjatë veprimtarive monitoruese/vlerësuese dhe inspektuese në institucionet arsimore, grupet vlerësuese, bazuar në gjetjet dhe gjykimet gjatë vitit 2024, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor që ato ofrojnë, kanë këshilluar institucionet arsimore parauniversitare: Drejtoritë e shkollave, të monitorojnë veprimtarinë e ekipeve kurrikulare në shkolla, për efikasitetin e këtyre ekipeve; Drejtoritë e shkollave, të hartojnë: plane afatmesëm sipas përcaktimeve ligjore, plane vjetore mbi objektiva të matshëm dhe të krahasueshme në bashkëpunim me grupet e punës si dhe të vlerësojnë me objektivitet dhe të realizojnë vlerësimin e brendshëm të IAP-së sipas udhëzuesve të ASCAP; Stafi drejtues, të hartojë dhe realizojë planin vjetor/mujor/javor të vlerësimit të procesit mësimor; Drejtoritë e shkollave, të përdorin instrumente vlerësimi vjetore për mësuesit bazuar në “Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AF, AMU e AML”, analizat e vlerësimit të arritjeve dhe kriteret zyrtare; Drejtoritë e shkollave për vlerësimin e arritjeve, të përdorin instrumente vlerësimi duke ju referuar vlerësimit të brendshëm të shkollës; ZVAP-të për procedurat e lëvizjes paralele dhe emërimet e mësuesve, të zbatojnë përcaktimet e Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

Objektivat për vitin 2025: Zhvillim i vazhdueshëm profesional i stafeve të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe të strukturave të varësisë; Forcimi i llogaridhënies dhe garantimi i transparencës në vendimmarrje nga institucionet e varësisë; Koordinimi i punës me DRAP/ZVAP në funksion të ofrimit dhe sigurimit të shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

7. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në juridiksionin e saj tre inspektorate shtetërore.

7.1 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)


AKU është krijuar bazuar në ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar. Organizimi dhe funksionimi i institucionit është përcaktuar me vkm nr. 708, datë 09.009.2020, AKU filloi funksionimin më 20.05.2010, pra një institucion me një historik aktiviteti relativisht të ri dhe në përpjekje për të realizuar misionin e tij në zbatim të kërkesave ligjore dhe legjislacionit në fuqi.

Misioni i AKU është garantimi i sigurisë dhe cilësisë së zinxhirit ushqimor, promovimi i produkteve të sigurta dhe parandalimi i cenimit të cilësisë dhe mashtrimit me produktet ushqimore.

AKU, nga mbikëqyrja në periudhën kohore janar-dhjetor 2024, ka kryer në *total* 32614 inspektime në terren, nga të cilat 24908 inspektime të programuara dhe 7706 jashtë programit.

Nga mbikëqyrja për periudhën kohore janar-dhjetor 2024, në sistemin online “e-Inspektimi”, shënon total 33797 rezultate, nga të cilat me status mbyllur në total 32503 inspektime. Nga DRAKU janë programuar 24666 inspektime, ndërsa nga Inspektorati Qendror janë miratuar 26833 inspektime, nga të cilat 3731 nuk janë hapur në sistem, ndërsa 603 janë realizuar pa mendimin këshillimor të IQ.

Sipas të dhënave në sistem janë realizuar me status mbyllur, sipas programit 23884 inspektime dhe jashtë programit 8619 inspektime (27% e inspektimeve janë jashtë programi).



AKU ka kryer inspektime jo nëpërmjet sistemit online “e-Inspektimi” edhe 79.738 inspektime për import në Pikat e Inspektimit Kufitar, si dhe 2.879 për eksporte të produkteve, të realizuara me dokumente të parashtypura me nr. serial.

Në regjistrin e gjobave të sistemit “e-Inspektimi” rezultuan 239 *çështje inspektimi me masë administrative gjobë*¹⁴ dhe 301 gjoba.

Nga të dhënat e dërguara nga AKU, vlera gjithsej e gjobave është 44.670.000 lekë, si dhe janë vjelur 35.247.244 lekë.

Janë ankuar pranë KSHA 47 gjoba, nga të cilat 43 lënë në fuqi, 2 shfuqizuar dhe 2 ndryshuar dhe janë ankuar MBZHR 47 gjoba, ku 40 janë lënë në fuqi, 2 shfuqizuar dhe 5 ndryshuar. Ndërsa, ecuria e ankimit gjygjësor është 22 lënë në fuqi, 2 shfuqizuar, 6 ndryshuar, si dhe 68 janë në proces.

Arritjet: Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, AKU realizoi gjithsej 111,785 inspektime, nga të cilat 32,047 ishin në terren dhe 79,738 në Pikat e Inspektimit Kufitar, me një përqindje realizimi prej 109.3% në terren dhe 86.2% krahasuar me planin zyrtar. Në kuadër të Task-forcës Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik Veror 2024, u kryen 8,610 inspektime, duke tejkaluar planin me 100.4% realizim. AKU forcoi bashkëpunimin ndërinstitucional me ISUV dhe MBZHR, duke unifikuar metodat laboratorike dhe përditësuar protokollet në laboratorët fiziko-kimik dhe fitosanitar. Një tjetër bashkëpunim i rëndësishëm u zhvillua me AKVMB për zbatimin e Planit të Monitorimit të Dëmtuesve me Bazë Risku, falë furnizimeve nga projekti SAFIAL në laboratorin fitosanitar të DRAKU Durrës. Pjesëmarrja e stafit në 42 trajnime të organizuara nga EFSA, BTSF, UNIDO, IQ dhe ASPA kontribuo në rritjen e kapaciteteve profesionale. Në Platformën e Bashkëqeverisjes u trajtuan 42 ankesa/kërkesa nga OBU-të dhe qytetarët, ndërsa paralelisht u zhvilluan fushata ndërgjegjëse për sigurinë ushqimore, përfshirë temat mbi shërbimin e akullores dhe gjurmueshmërinë e produkteve. AKU ndërgjegjësoi 128 nxënës dhe të rinj si “Ambasadorë të Sigurisë Ushqimore” në rajonet e Korçës dhe Elbasanit. Gjithashtu, u trajtuan 222 ankesa në total, të adresuara përmes e-mailit zyrtar, numrit të gjelbër dhe rrjeteve sociale.

Objektivat për vitin 2025: Gjatë vitit 2024, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka garantuar sigurinë ushqimore përmes koordinimit dhe bashkërendimit të kontrollit zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, si dhe forcimit të kapaciteteve laboratorike për analizimin e mostrave. Zbatimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut për 24,019 operatorë të biznesit ka ndihmuar në përmirësimin e mbikëqyrjes dhe menaxhimit të risqeve në sektorin ushqimor. Janë ndërmarrë iniciativa për informimin e operatorëve mbi praktikat më të mira të përpunimit dhe parandalimin e falsifikimeve, si dhe për promovimin e produkteve të sigurta, duke parandaluar cënimin e cilësisë së ushqimeve. Po ashtu, janë forcuar kapacitetet administrative të AKU dhe është funksionalizuar përmirësimi i sistemit AKU Net në bashkëpunim me AKSHI. Një tjetër prioritet ka qenë zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse, duke synuar sensibilizimin e konsumatorëve dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU), si dhe përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore dhe burimeve financiare për të rritur efikasitetin e inspektimeve dhe monitorimeve.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: AKU ka Program Vjetor, i cili është sjellë për mendim këshillimor brenda afatit, të përcaktuar në Vendim nr. 696, të Këshillit të Ministrave,

¹⁴ një çështje inspektimi mund të përmbajë më shumë se një masë administrative me gjobë

datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, por procesi i miratimit të programit vjetor nga Ministri Përgjegjës, edhe këtë vit sikurse edhe vitet e fundit, pati vonesë, gjë e cila solli mos paraqitjen nga AKU për mendim këshillimor të programit të muajit janar, për rrjedhojë edhe mungesën e hedhjes së programit për këtë muaj.

AKU **Sektorët UUKOBU dhe MBIB** e realizojnë veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin për inspektimin, me dokumentacion standard, online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, me program vjetor dhe programe mujore të gjeneruara në portal.

Sektori i PIK vijon të mos kryejë inspektime online në sistemin “e-Inspektimi”, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10433/2011 dhe aktet nënligjore përkatëse. Kjo pengon gjurmueshmërinë, transparencën dhe monitorimin e efektivitetit të inspektimeve, duke sjellë rrezik për standardizimin dhe cilësinë e procesit inspektues.

AKU ende nuk ka hartuar procedura të veçanta për licencimin në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pajisjen me Akt-Miratim Higjiëno-Sanitar, si dhe për produktet e destinuara për asgjësim, duke përfshirë edhe listat përkatëse të verifikimit dhe aktet nënligjore të nevojshme.

AKU nuk ka paraqitur pranë Inspektoratit Qendror modelet e buletineve statistikore për informatizimin e tyre në sistemin “e-Inspektimi” përmes komunikimit të duhur administrativ, por është mbështetur në observacionet e mbikëqyrjes, në vend të një komunikimi zyrtar dhe të drejtpërdrejtë, siç kërkohet nga Inspektorati Qendror për të siguruar reflektimin e saktë dhe të dakordësuar të të dhënave në sistemin “e-Inspektimi” (zbatim në pikën 15.1 të raportit të KLSH).

AKU nuk njofton paraprakisht subjektet për inspektime që kryhen me kërkesën e tyre (p.sh., pajisja me Akt-Miratim Higjiëno-Sanitar, asgjësimi, licencimi). Kjo çon në mosefektivitet të trupës inspektuese, pasi subjektet nuk janë të përgatitura për inspektimin dhe nuk ka një rrezik që të justifikojë mungesën e njoftimit.

Gjithashtu edhe Inspektimi në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore nuk kryhet me njoftim paraprak në masë.

Shumë veprimtari inspektuese kryhen pa përdorimin e pajisjeve elektronike (tableta), duke mos mundur verifikimin e vendndodhjes reale të inspektorëve. Inspektimet e kryera pa GPS, kanë rritur rrezikun e pasaktësive dhe mungesës së kontrollit mbi inspektimet.

Nga monitorimi i sistemit “e-Inspektimi”, rezulton se nuk ka një regjistër të plotë mbi ecurinë e masave administrative (nëse janë ankimuar, paguar, datat e pagesave etj.), në kundërshtim me vkm nr. 696/2013. Kjo krijon mungesë gjurmueshmërie dhe transparence në ndjekjen e penaliteteve të vendosura nga AKU.

Trupat inspektuese nuk pasqyrojnë në mënyrë të njëjtë dokumentet në sistemin elektronik “e-Inspektimi” dhe ato në protokollin fizik të drejtorive përkatëse. Kjo krijon paqartësi dhe mungesë transparence në sistemin online, duke cënuar integritetin e procesit inspektues.

Në rastet kur merren mostra për analizë nga produktet ushqimore, nuk ka dokumentim të duhur për mostrat e marra si detyrim ligjor. Kjo mund të ndikojë në besueshmërinë e provave dhe saktësinë e vendimeve të inspektimit.

Çështjet në shumë raste nuk përmbajnë të bashkëlidhur dokumentacion justifikues për konstatimet në subjekt *me ose pa* gjetje, realizimin e detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm, marrjen e njoftimit të procesverbalit, shpjegimet apo kontestimet e subjektit mbi gjetjet e konstatuara në procesverbal (nëse ka), në përputhje me pikën 6, të shtojcës 2, të rregullores nr. 25/2018, të ndryshuar.

Problematikat: Problem kryesor mbetet mungesa e inspektorëve me formim mjek veteriner, e cila ndikon në certifikimin dhe kontrollin e produkteve me origjinë shtazore për eksport, si dhe në marrjen e mostrave të molusqeve dhe produkteve të peshkut. Po ashtu, mosrealizimi i planit të inspektimeve me 10% ka ardhur si pasojë e vonimit të miratimit të planit të kontrolleve zyrtare me bazë risku, angazhimit të inspektorëve në monitorime të tjera dhe mungesës së burimeve njerëzore në disa qarqe. Mungesa e produkteve për analizë në treg, si dhe problemet e identifikuara në sektorët e PP-ve, PMB-ve dhe MMSHB-ve, përfshirë shitjen e produkteve të pa licencuara, mungesën e kushteve higjieno-sanitare, shkelje në magazinim dhe etiketim, vijnë të jenë shqetësuese. Një tjetër problem është mungesa e mjeteve për transportin dhe garantimin e mostrave, si dhe asgjësimi i PMB-ve të bllokuara, për shkak të mosvënies në dispozicion të subjekteve të licencuara për asgjësim nga AKM. Infrastruktura mbetet një sfidë, përfshirë mungesën e kontrolleve zyrtare online dhe sistemeve elektronike për menaxhimin e të dhënave, duke bërë që informacionet tekniko-financiare të mbahen në tabela Excel, çka rrit mundësinë e gabimeve. Gjithashtu, mungesa e eksperiencës dhe trajnimeve për inspektorët dhe koordinatorët e raportimit, si dhe ngarkesa e lartë e raportimeve, ndikojnë në cilësinë e punës dhe efektivitetin e kontrolleve.

7.2 Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA)

Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) ka mision kontrollin e peshkimit, nëpërmjet aktiviteteve inspektuese, në ujë apo në tokë, përfshirë portet, pikat e zbarkimit, mjetet e transportit, qendrat e grumbullimit të peshkut, merkatot, pikat e shitjes dhe restorantet, sipas legjislacionit në fuqi për peshkimin. Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit është përgjegjëse për të monitoruar respektimin rregullsisë së zënieve që ndodhen në bordin e mjetit lundrues të peshkimit, të magazinuara, të transportuara, në përpunim apo të tregtuara, si dhe vërtetësinë dhe saktësinë e dokumenteve apo transmetimeve elektronike që lidhen me to.

DSHPA, zhvillon veprimtarinë inspektuese në bazë të ligjit nr. 64/2012, “Për Peshkimin”, i ndryshuar, i cili pësoi ndryshime gjatë vitit 2024 me ligjin nr. 98/2024, datë 12.9.2024, si dhe


vkm-së nr.719 datë 20.10.2011, “Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë”, i ndryshuar.

Fushat e përgjegjësisë janë si më poshtë:

- ✓ rregullsia e veglave të peshkimit të përdorura dhe për zëniet e tyre që janë në bordin e anijes së peshkimit;
- ✓ planin e ngarkesës dhe ngarkesat e veçanta të llojeve;
- ✓ shënjimi i veglave të peshkimit;
- ✓ informacioni përkatës për motorin, ashtu siç parashikohet në ligj.

DSHPA kryen aktivitetin inspektues në dy fusha inspektimi: Peshkimi dhe Akuakulturë. Trupa inspektuese e DSHPA ka aktualisht në përbërje 18 inspektorë, nga 30 inspektorë që ka në strukturën e vet.

Gjatë vitit 2024, DSHPA ka kryer 1343 inspektime në të gjithë territorin, nga të cilat 1324 inspektime të programuara dhe 19 jashtë programit, të kryera në sistemin “e-Inspektimi”, si më poshtë:



Nga Regjistri elektronik i gjobave rezulton se për vitin 2024, nga sektori i inspektimit në DSHPA janë vendosur 13 masa administrative gjobë, me një vlerë prej 2.147.000 lekë. Gjatë këtij viti janë bërë edhe 18 propozime për heqje liçense.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: DSHPA kryen veprimtarinë inspektuese në zbatim të legjislacionit për inspektimin, për pjesën e programimit të inspektimeve, por edhe me disa devijime nga programi i paraqitur; Në lidhje me procedurën inspektuese, vazhdon të ketë disa mungesa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm të inspektimit, si dhe mos kryerjen e inspektimeve me tableta inspektimi, sipas detyrimit ligjor, ku evidentohet se 99

procedura të tilla inspektuese; Dokumentacioni i inspektimit nuk plotësohet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi; Në procesverbalin e inspektimit nuk përshkruhen me saktësi llojet e gjetjeve të konstatuara, për të argumentuar sa më qartë masën administrative të marrë; Në procedurën e inspektimit, të gjitha faktet dhe shkeljet e konstatuara nuk dokumentohen me dokumentacion të plotë rreth fakteve të mbledhura, gjë e cila, çon në marrje vendimi përfundimtar të pa argumentuar.

Arritjet: Gjatë kontrolleve të ushtruara në liqenet e Republikës së Shqipërisë janë marrë masa për evidentimin dhe parandalimin e gjuetisë së paligjshme në bashkëpunim edhe me OMP e këtyre liqeneve; Kryerja e inspektimeve me shtrirje gjatë vijës bregdetare ku janë dhe problematikat më të mëdha; Ndërhyrje në liqenin e Ohrit për garantimin e zbatimit të Urdhrit të Ministrit dhe ecurisë së grumbullim-inkubimin e vezëve të Koranit; Grumbullimi i taksës kombëtare brenda afatit të përcaktuar në rregullore; Evidentimi dhe parandalimi i gjuetisë së paligjshme në det; Kontroll në pikat e tregtimit dhe magazinimit të produkteve të pa shoqëruar me çertifikatë origjine apo produkteve të ndaluara; Ndërhyrje në liqenin e Shkodrës dhe Ulëz-Shkopetit për garantimin e zbatimit të urdhrit të ministrit “Për ndalimin e peshkimit të Krapit në liqenin e Shkodrës”; Grumbullimi i taksës kombëtare vjetore të subjekteve që kryejnë aktivitet peshkimi dhe akuakulture.

Problematikat: Mungesa të theksuara në pajisje logjistike, pasi vija bregdetare ku janë evidentuar problematikat në fushën e peshkimit është shumë e gjatë dhe në terrene të vështira; Vija bregdetare që i duhet të mbulojë një inspektor arrin deri në 70 km, ku mungesa e logjistikës tokësore dhe asaj ujore është një problematikë e cila kushtëzon kryerjen e detyrave të inspektorit, për evidentimin dhe parandalimin gjuetisë së paligjshme; Organizimi i gjuetisë bregdetare nëpërmjet OMP-ve, praktikë kjo e cila ka rezultuar e suksesshme në liqenin e Shkodrës dhe Pogradecit; Mungesa e dokumentacioneve nga ana e mjeteve të vogla (sanalle) e bën të pamundur aplikimin për pajisje me licencë peshkimi. Mbetet akoma problematike situata në Liqenin e Fierzës, pasi nga ana e OMP-së nuk është hartuar akoma lista e peshkatarëve dhe plani i bashkëmenaxhimit i cili do të përcaktojë numrin e licencave në liqen, sidomos në Kukës.

Objektivat për vitin 2025: Parandalimi dhe evidentimi i gjuetisë së paligjshme; Fushata sensibilizuese për subjektet për ndërgjegjësimin mbi tregtimin e specieve të ndaluara dhe njohja me ligjin e Peshkimit; Monitorim i Hapësirës detare nëpërmjet sistemit VMS dhe patrullimit në bashkëpunim; Kontrolle në gjithë vijën bregdetare për Peshkimin e Paligjshëm Artizanal; Marrja e masave administrative për anijet e peshkimit që do të konstatohen në shkelje; Inspektim në pikat e tregtimit dhe magazinimit të produkteve të pa shoqëruar me çertifikatë origjine apo produkteve të ndaluara; Ndërhyrje në liqenin e Ohrit për garantimin e grumbullim-inkubimin e vezëve të Koranit; Ndërhyrje në liqenin e Shkodrës dhe Ulëz-Shkopetit për zbatimin e Urdhrave të Ministrit; Grumbullimi i taksës kombëtare brenda afatit të përcaktuar në rregullore.

7.3 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në zbatim të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, është struktura përgjegjëse për të siguruar respektimin e kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të zonave të mbrojtura, për monitorimin dhe inspektimin e të gjitha veprimtarive që rrezikojnë të dëmtojnë biodiversitetin, popullatat e specieve të florës dhe faunës së egër, sëmundjet dhe dëmtuesit, ndotjen e mjedisit, monitorimin e gjuetisë, prerjeve të paligjshme, të ndërhyrjeve dhe zënies së sipërfaqeve në fondin pyjor, gjermime në shtratet e lumenjve dhe mbrojtjen e territorit të zonave të mbrojtura nga zjarret.

AKZM-ja, ushtron funksionet e saj në zbatim të vkm nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura”, i ndryshuar dhe veprimtaria inspektuese është e strukturuar në një sektor inspektimi në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 12 Administrata të zonave të mbrojtura, si dhe ka në përbërje 39 inspektorë.

Administrata qendrore planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit, siguron unifikimin e praktikave të inspektimit në shkallë vendi, informon publikun për veprimtarinë e inspektimit, përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit, si dhe kryen drejtpërdrejt inspektime ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit, të cilat kryejnë veprimtari me rrezik të lartë. Ndërsa, administrata e zonave të mbrojtura ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në këto zona.

Nga të dhënat e nxjerra nga sistemi, AKZM për vitin 2024, ka kryer 124 inspektime gjithsej, nga të cilat 24 të programuara dhe 100 jashtë programit. Trupa inspektuese e AKZM, për shkelje të konstatuara nga subjektet e inspektuara, ka vendosur 47 masa administrative “gjobë”, me vlerë në total 5.330.000 lekë, si dhe të ardhurat në buxhet nga arkëtimet e gjobave janë në shumën 1.170.000 lekë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit ka shqyrtuar 19 vendime administrative me gjobë të ankimuara, nga të cilat: 2 vendime janë shfuqizuar, 14 vendime janë lënë në fuqi dhe 3 vendime janë ankimuar në gjykatë.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të inspektimeve për vitin 2024, por nuk është paraqitur sipas formatit të përcaktuar ligjor; AKZM e kryen të gjithë veprimtarinë inspektuese pa tabletë inspektimi apo dokumentacioni nuk mbahet në subjektin e inspektimit; Procesverbali dhe Vendimi përfundimtar i inspektimit nuk janë të plotësuar në mënyrë shteruese për sa i takon bazës ligjore të konstatimeve apo dënimeve administrative; Autorizimi i inspektimit nuk njoftohet në rastet e inspektimeve të programuara; Listë verifikimi plotësohet me mangësi, e cila sjell situatë të pasaktë ligjore të subjektit të inspektimit; Njoftimi i Vendimit përfundimtar të inspektimit nuk ngarkohet në sistem si pjesë e dosjes elektronike të inspektimit; Subjektit të inspektimit i lihen vetëm detyra për t’u realizuar, por nuk evidentohet në sistemin online të inspektimeve të dhëna të mëtejshme për realizimin e tyre, apo të planifikohet riinspektim; Në sistemin “e-Inspektimi”, nuk është pasqyruar ecuria e masës administrative “gjobë”.

Arritjet: Realizimi për herë të parë i veprimtarisë inspektuese online në portalin “e-Inspektimi”, dhe me dokumente standarde. Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të inspektimit duke rritur aftësinë e inspektorëve për kryerjen dhe përmirësimin e veprimtarisë inspektuese në zonat e mbrojtura. AKZM nëpërmjet unifikimit të procesit inspektues, ka rritur në mënyrë të ndjeshme transparencën e procedurave të inspektimit dhe efektivitetin duke synuar ngritjen e vazhdueshme profesionale të inspektorëve në 12 ADZM-të e qarqeve, me qëllim forcimin e kontrollit në territorin e zonave të mbrojtura.

Problematikat: Nevoja për përmirësim të listës verifikimit me rubrika shtesë të aktiviteteve me risk, referuar bazës ligjore dhe ndryshimeve që ka pësuar ligji “Për zonat e mbrojtura”.

Objektivat për vitin 2025: Vijueshmëria e inspektimeve online dhe përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të inspektimeve nga ADZM-të rajonale.

8 MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

8.1 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)


ISHSH, ka si mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. ISHSH-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike.

Në zbatim të vkm nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror shëndetësor”, ISHSH në nivel qendror planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit; siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi; bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve dhe siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të akredituar; informon publikun për veprimtarinë e inspektimit; jep mbështetje teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit; përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit si dhe kryen drejtpërdrejt inspektime ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë. Degët rajonale të ISHSH-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin.


Trupa inspektuese e ISHSH ka aktualisht në përbërje rreth 240 inspektorë dhe një strukturë prej 305 punonjësish në total.

ISHSH, gjatë vitit 2024, ka programuar të total për 12 qarqe dhe drejtorinë qendrore, 22.407 inspektime. Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024, ISHSH ka kryer në total 24.392¹⁵ inspektime, nga të cilat 21.250 janë të programuara dhe 3.142 jashtë programi, pra 13 %.

¹⁵ Inspektime të cilat janë me statusin “Mbyllur”.



Në mënyrë grafike arsyet e inspektimeve jashtë programi, janë si mposhtë.




Trupat inspektuese kanë marrë 170 vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative gjobë.

Më poshtë, pasqyrohen grafikisht masat administrative (gjobë), sipas qarqeve, të marra në inspektime të programuara dhe jashtë programi.

Masa Administrative Gjobë 2024


■ Programuar ■ Jashte programi



Gjithashtu, ISHSH ka marrë 1509 vendime përfundimtare inspektimi me masa administrative “paralajmërim”. Vihet re se Drejtoria e Përgjithshme dhe ISHSH Kukës, ISHSH Lezhë, nuk kanë marrë asnjë masë administrative.

MA Paralajmërim krahasuar me MA Gjobë 2024

■ MA Paralajmërim ■ MA Gjobë



ISHSH ka marrë 170 Masa Administrative Gjobë gjatë vitit 2024, me vlerë 41,720,000.

Komisioni i Ankimit të Gjobave ka organizuar pranë ISHSH qendror 6 (gjashtë) Komisione të Ankimit ku janë shqyrtuar 112 Masa Administrative dhe:

- 108 Masa Administrative janë lënë në fuqi.
- 4 Ankime Administrative janë pranuar.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 112 Procese Gjyqësore nga të cilat:

- 44 Procese Gjyqësore janë fituar.
- 25 Procese Gjyqësore janë humbur.
- 43 Procese Gjyqësore janë në procedurë, dhe,
- 18 Procese Gjyqësore janë në procedurë Apeli Administrativ.

Përsa i përket vjeljes së gjobave ISHSH ka:

- 91 Masa Administrative me Vendim Lëshim Urdhër Ekzekutimi.
- 38 Masa të Ekzekutuara.
- 52 Masa Administrative me Vendim Lëshim Urdhër Ekzekutimi janë në procedurë.

Për vitin 2024, ka në total 79 masa të ekzekutuara me vlerë 25.623.408 lekë, nga të cilat 57 masa në vlerë 7.504.400 lekë janë bërë në mënyrë vullnetare.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: ISHSH realizon veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet tabletës por 21 % të inspektimeve i ka realizuar nëpërmjet web-it. Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të inspektimeve, për vitin 2024 dhe në Programet Mujore të hartuar me listë subjektesh inspektimi, të hartuara me bazë risku; Inspektimet e ushtruara nga ISHSH kryen me autorizim, por nuk dokumentohet gjithmonë, njoftimi paraprak i autorizimit; Në rastet kur inspektimi realizohet pa njoftim paraprak, nuk dokumentohet gjithmonë, njoftimi përpara fillimit të veprimeve të inspektimit dhe mosnjoftimi nuk motivohet në përputhje me ligjin; Kur inspektimi realizohet jashtë programi nuk ndodhet bashkëlidhur dokumentacioni për realizimin e kësaj procedure; Në disa raste shtyrja e autorizimit nuk bëhet në përputhje me parashikimet ligjore; Shpesh dokumentacioni i veprimtarisë inspektuese, nuk plotësohet, përgjithësisht, në të gjitha fushat e tyre, por ka raste kur ka mangësi dhe nuk detajohen gjetjet, konstatimet apo nuk pasqyrohen të gjitha veprimet e marrë; Ka raste kur dokumentacioni nuk plotësohet pranë subjektit dhe ka mospërputhje midis kohëzgjatjes së deklaruar të inspektimit në procesverbal dhe kohëzgjatjes së mbajtjes së dokumentacionit në sistem; Ka raste kur shkeljet e konstatuara në listë verifikimi nuk pasqyrohen në procesverbal dhe rrjedhimisht as nuk merren masat administrative përkatëse; Në rastet kur dokumentacioni nuk nënshkruhet nga subjekti i inspektimit, nuk dokumentohet gjithmonë marrja dijeni për procedurën e inspektimit të mbajtur; Shumë masa administrative janë marrë, në kushtet e flagrancës por procedura nuk realizohet sipas parashikimeve ligjore dhe nuk dokumentohen apo pasqyrohen kushtet e flagrancës; Ka raste kur masat administrative nuk merren në përputhje me ligjin.

Arritjet: Puna dhe aktiviteti i ISHSH gjatë vitit 2024 janë kryer bazuar në përvojën më të mirë dhe duke pasur në synim funksionimin e një institucioni që i përgjigjet kërkesave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës. ISHSH ka marrë masat për: sigurimin e një sezoni turistik të sigurtë dhe të shëndetshëm me qëllim respektimin e kushteve higjieno sanitare dhe minimizimi i rasteve të intoksikacioneve alimentare dhe hidrike apo sëmundjeve të tjera infektive të lëkurës; evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi me qëllim sigurimin e kushteve optimale të mësimi dhe jetesës në institucionet arsimore parashkollore, shkollore dhe universitare në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; inspektimin e subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm duke minimizuar

shpërthimet e sëmundjeve infektive me origjinë hidrike; evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatueshmëria e rregulloreve të MSHMS në funksion të evidentimit të plotësimit të standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit në shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor publik; evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatueshmëria e rregulloreve të MSHMS në funksion të plotësimit të standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitetet që ofrohen në shërbimin spitalor në kuadër të Reformës së Autonomisë Spitalore; evidentimi i derdhjeve të ujërave të zeza në zonat turistike dhe kushteve higjieno-sanitare të subjekteve akomoduese dhe restorantet me qëllim shmangien e ngjarjeve të padëshiruara në shëndetin e popullatës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 20, datë 01.03.2023, “Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2023”. Gjatë vitit 2024 ISHSH ka arkëtuar të ardhura në vlerën 40.240.145 lekë me rritje 31% në krahasim me vitin 2023, kur të ardhurat ishin 30.604.361 lekë.

Problematikat: Mungesa e automjeteve të transportit për trupat inspektuese në kryerjen e detyrave funksionale të institucionit, të cilat sjellin vështirësi në realizimin e procedurës inspektuese brenda kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim; mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB, e cila sjell që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden nga inspektorët në adresat që ata kanë deklaruar në QKB.

Objektivat për vitin 2025: Do të jenë realizimi i inspektimeve të programuara për vitin 2025; Marrja pjesë në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Çështjet e Integritetit Europian, Kapitulli 28, Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale; Inspektime para dhe gjatë sezonit turistik veror, me qëllim krijimin e kushteve optimal për një sezon turistik veror të sigurt; Inspektime për evidentimin e kushteve higjieno-sanitare në subjekte publike dhe jopublike arsimore, me qëllim sigurimin e kushteve të mira shëndetësore; Inspektime në subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm; Inspektime për plotësimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitetet që ofrohen në shërbimin spitalor, në kuadër të Reformës së Autonomisë Spitalore; Inspektime për plotësimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitet që ofrohen në shërbimin parësor; Inspektime për monitorimin e zbatimit të ligjeve të veçanta në kompetencë të ISHSH, për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji, për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, për produktet kozmetike, për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar; Sigurimi i kryerjes së inspektimeve “inteligjente” mbi bazë risku në shëndet publik dhe sipas riskut të historikut të inspektimeve etj...


8.2 Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)

AKBPM, është një institucion i specializuar për analizën dhe kontrollin e barnave, për dhënien e autorizimit për tregtim, për inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike, për farmakovigjilencën dhe për administrimin e standardeve të pajisjeve mjekësore.

Ndër funksionet e AKBPM është inspektimi i barnave pranë subjekteve farmaceutike, të cilat kanë të bëjnë me vendosjen në treg, tregtimin me shumicë dhe pakicë, kushtet e ruajtjes së barnave, lëndëve të para dhe ndihmëse e materialeve ambalazhuese, tregtimin dhe

eksportimin e barnave të prodhuara nga fabrikuesit vendas, importin e barnave, autorizimin për import, si dhe pajisjeve mjekësore. Ky institucion e ushtron veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, ligjit nr. 89/2014, “Për Pajisjet Mjekësore”, i ndryshuar, vkm nr. 24, datë 14.01.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore”, e ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Në zbatim të vkm nr. 24, datë 14.01.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore”, i ndryshuar, AKBPM ka gjithsej 99 punonjës. Sektori i inspektimit ka 21 punonjës nga të cilët 20 inspektorë dhe 1 shef sektori, përgjegjës për inspektimin në fushën farmaceutike për barna dhe pajisje mjekësore.




AKBPM, gjatë vitit 2024, ka programuar në total 502¹⁶ inspektime. Nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”, rezulton se janë realizuar 470¹⁷ inspektime, nga të cilat 446 janë të programuara dhe 24 jashtë programi (pra rreth 5 %).

Në mënyrë grafike arsyet e inspektimeve jashtë programi, janë si më poshtë.

¹⁶ Reference programet mujore të dërguara pranë Inspektoratit Qendror për mendim këshillimor.


¹⁷ Inspektime të cilat janë me statusin “Mbyllur”. Ne sistem figurojnë 443 inspektime të programuara dhe 75 jashtë programi por nga 75 inspektime jashtë programi, 51 prej tyre janë realizuar me arsye “*inspektime të programuara*”. Pra në total janë 494 inspektime të programuara dhe 24 jashtë programi.

Arsyet e Inspektimit Jashtë Programi



AKBPM është përgjegjëse për 5 fusha inspektimi për të cilat realizon veprimtarinë inspektuese. Gjatë vitit 2024, janë realizuar inspektime vetëm në 4 fusha, Farmaci Private, Depo Farmaceutike, Depo e Pajisjeve Mjekësore dhe Fabrikuesit e Barnave. Në fushën Farmaci Spitalore nuk është realizuar asnjë inspektim, pavarësisht se është planifikuar edhe në programin vjetor të inspektimit për vitin 2024.

Inspektimet sipas fushës së inspektimit



Gjatë vitit 2024, janë marrë 33 Vendime Përfundimtare Inspektimi me masë administrative gjatë, nga të cilat 26 janë marrë në inspektime të programuara dhe 7 në inspektime jashtë programi (21.21 %).

Përsa i përket ecures së masës administrative, janë paraqitur 7 ankime në rrugë administrative, pranë Komisionit të Ankimit, nga të cilat 6 janë lenë në fuqi dhe 1 është shfuqizuar.

Nga analiza vjetore e vënë në dispozicion nga AKBPM rezulton se, për vitin 2024, vetëm një çështje është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë, e cila ka rrëzuar pretendimin e palës paditëse duke lënë në fuqi vendimin përfundimtarë të inspektimit.

AKBPM, ka marrë 33 masa administrative gjobë me vlerë totale 5.850.000 lekë (1 masë administrative me vlerë 200.000 lekë shfuqizuar me vendim të Komisionit të Ankimit), nga të cilat janë arkëtuar 2.163.820 lekë ose në masën rreth 37%.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: AKBPM e realizon veprimtarinë inspektuese online, 100 % nëpërmjet pajisjeve tabletë; Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të Inspektimit për vitin 2024 dhe në programe mujore të hartuara me listë subjektsh inspektimi me bazë risku, por këto programe nuk dërgohen gjithmonë, pranë Inspektoratit Qendror brenda afateve ligjore, të parashikuara në vkm nr. 696/2013; Inspektimet e ushtruara nga AKBPM kryen me autorizim dhe dokumentacionin e veprimtarisë inspektuese, por në disa raste nuk plotësohet në të gjitha rubrikat përkatëse dhe në dosje nuk pasqyrohen të gjitha veprimet e procedurës inspektuese, me dokumentacion bashkëlidhur; Përsa i përket ecurisë administrative në sistem janë pasqyruar ankimet administrative të cilat nuk janë realizuar plotësisht në përputhje me ligjin për inspektimin, në sistem nuk gjenerohet “Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit”; Procedura inspektuese, në përgjithësi, realizohet konform ligjit nr. 10433/2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

Objektivat për vitin 2025: Objektivat e angazhimit kryesorë për t’u arritur gjatë vitit 2025, janë të fokusuara në shumëllojshmërinë e barnave në treg, duke ruajtur cilësinë dhe duke rritur disponueshmërinë, ofrimin e shërbimit cilësor farmaceutik të disponueshëm në të gjithë territorin, forcimin e kontrollit dhe inspektimit të pajisjeve mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, me qëllim përmirësimin e nivelit të mbrojtjes dhe sigurisë të shëndetit të pacientëve apo përdoruesve të tyre në përputhje me nivelet e efektshmërisë së pajisjeve mjekësore të siguruara nga prodhuesit. Objektivat e Sektorit të Inspektimit që do jenë: bashkëpunimi me QKB, UFSH dhe Policinë e Shtetit, ndërgjegjësim dhe edukim, këshillim në lidhje me tregtimin e barnave vetëm me recetën mjekësore, inkurajimi i raportimit të çdo efekti të padëshiruar nga barnat nëpërmjet QR Code, këshillim mbi regjistrimin e pajisjeve mjekësore; inspektime periodike mbi subjektet e regjistruara për të siguruar zbatimin e ligjit dhe rregulloreve, krijimi i planeve të inspektimit duke vlerësuar periodicitetin e kontrolleve të shtrira në kohë dhe faktorët e riskut, përmirësimi cilësor i inspektimeve dhe evidentimi i saktë në portalin “e-Inspektimi”. Vëmendje të veçantë gjatë sezonit turistik do ketë inspektime në subjektet farmaceutike për të verifikuar dhe ndëshkuar rastet e shkeljeve në shitjen e barnave me çmim më të lartë se ato të përcaktuara nga autoritetet kompetente, zbatimi i standardeve të Praktikës së Ruajtjes dhe Shpërndarjes së Mirë të Barnave.

8.3 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR)

ZMR, ka mision kryesor përcaktimin e kushteve të mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese dhe jo jonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe

pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar në maksimum të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese, si dhe monitorimin e rrezatimeve jo jonizuese.

ZMR, gjatë vitit 2024, ka realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private, që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X dhe në ato qendra ku aplikohet veprimtari me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive. Gjatë inspektimit bazuar në objektin e inspektimit, janë realizuar dhe matje në lidhje me fuqinë e dozës, në ambientet publike dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues. Në bazë të këtyre matjeve është përlllogaritur doza efektive vjetore për publikun dhe personelin.


Veprimtaria inspektuese e saj është realizuar në funksion të kërkesave të ligjit nr. 8025, date 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar, ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jo jonizuese", i ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, si dhe është e organizuar në nivel qendror në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

ZMR, në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2024, ka planifikuar 156 inspektime dhe ka realizuar ne total 145 inspektime nga ku 141 brenda planit dhe 4 inspektime jashtë planit.

Në zbatim të udhëzimit nr.1885/7, datë 19.09.2016, "Për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit nga inspektorët e ZMR-së", gjatë procesit të inspektimit janë marrë gjithsej 79 masa administrative nga të cilat: 61 Dënim administrativ kryesor "Paralajmërim"; 3 Dënim administrativ kryesor "Heqje licencë", si dhe 15 Dënim administrativ kryesor "Gjobë", me vlerë gjithsej 740.000 lekë.

Nuk është ankimuar asnjë nga masat administrative që kanë marrë inspektorët e ZMR- së, si dhe janë arkëtuar në total 11 gjoba me vlerën 410.000 lekë, pra janë arkëtuar rreth 55.4% e vlerës totale.

Më poshtë është paraqitur totali i inspektimeve online të planifikuara dhe masat administrative, të kryera në subjektet private dhe shtetërore gjatë vitit 2024.



Arritjet: Nga mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese, rezulton se ZMR realizon veprimtarinë inspektuese 100 % online, me tabletë (mobile), në përputhje të plotë me ligjin për inspektimin dhe ligjin për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese; realizon njoftimin paraprak të subjekteve që do të inspektohen brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Problematikat: ZMR vazhdon të mos kryejë inspektime për sa i përket zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jo jonizues, kjo për arsye të mungesës së pajisjeve për kryerjen e matjeve të rrezatimit jo jonizues, si dhe akoma nuk është finalizuar hartimi i listë-verifikimit për fushën e rrezatimeve jo jonizuese.

Objektivat: Për vitin 2025, ka planifikuar kryerjen e inspektimeve në subjekte private dhe shtetërore në të gjithë vendin, ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të kryhen online dhe me tableta, sipas ligjit për inspektimin dhe rifillimi i inspektimeve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jo jonizues.


8 MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

8.1 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ushtron inspektime duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

AKM, ushtron funksionet e saj në zbatim të vkm-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore. AKM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në 2 nivele: nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM).

Gjatë vitit 2024, AKM ka realizuar 1269 inspektime gjithsej, ku 1053 inspektime të programuara dhe 216 jashtë programit. Grafiku më poshtë, paraqet inspektimet e realizuara sipas rajoneve dhe fushave të inspektimit:



Trupa inspektuese ka marrë 102 masa administrative, nga të cilat 96, gjoba dhe 6 paralajmërime. Vlera në lekë e të gjitha masave të vendosura është 42.670.000 lekë nga të cilat janë arkëtuar një vlerë prej 4.590.000 lekë.

Për vitin 2024, pranë Komisionit të Ankimit në AKM janë depozituar dhe shqyrtuar 47 ankime administrative, nga të cilat:

- ✓ 16 masa administrative (gjobë) janë rrëzuar;
- ✓ 28 masa administrative (gjobë) janë lënë në fuqi;
- ✓ 3 masa administrative (gjobë) janë ndryshuar.

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, nuk rezulton të ketë ankime për vitin 2024.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: Procedura inspektuese, përgjithësisht, realizohet konform ligjit nr. 10433/2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi; AKM realizon veprimtarinë inspektuese nëpërmjet pajisjeve portabel tablet dhe laptop, në bazë të Programit Vjetor të inspektimeve për vitin 2024, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave, për fushën e mjedisit dhe ujërave të miratuar nga autoriteti përgjegjës; AKM ka sjellë Programe Mujore, për muajin Janar, Shkurt, Mars, Prill Maj, Qershor, Korrik, Gusht dhe Nëntor; Inspektimet e ushtruara nga AKM, përgjithësisht, janë kryer me Autorizim dhe me njoftim paraprak të autorizimit subjektivit të inspektimit; Ka raste kur Listë–Verifikimet, sipas objektit të inspektimit, për dokumentimin e veprimtarisë inspektuese nuk plotësohen tërësisht; Listë verifikimet, duhet të përditësohen

sipas formatit standard të miratuar nga Inspektorati Qendror (Po/Jo/NA) dhe gjithashtu duhet të riformulohen pyetjet e listë verifikimeve në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut; Procesverbali i Inspektimit, plotësohet në të gjitha fushat e tij, por konstatohen raste kur nuk detajohen gjetjet apo të pasqyrohen të gjitha konstatimet e procedurës inspektuese. Vendimi përfundimtar nuk ka të cituar përshkrimin e bazës ligjore për kërkesën e shkelur apo përshkrimin e bazës ligjore të masës administrative përkatëse; Konstatohet se është e nevojshme hartimi i rregullores për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative; Moduli “gjobat”, në sistemin “e-Inspektimi”, nuk pasqyron ecurinë e masës administrative; Dokumentet e veprimtarisë inspektuese të gjeneruara në sistem nuk janë të nënshkruara nga kryeinspektori, inspektorët apo subjekti i inspektimit, për inspektimet e realizuara me laptop.

Arritjet: Përmirësimi i metodës së raportimit të sistemit për incidentet dhe procesin e shqyrtimit, reduktim i ngarkesës së punës dhe kursimet e shpenzimeve të Institucionit; Inicimi i zbatimit të një procesi të kryerjes së më të efektshme të çështjeve dhe zhvillimin një menaxhimi elektronik sipas portalit “e-Inspektimi” për të përmirësuar përputhjen me procedurat e dokumentuara të inspektimit; Përmirësimi i menaxhimit për të siguruar vazhdimësi në detyrë për inspektimin; Informatizimi i ndjekjes së problematikës sipas sistemit unik; Përfshirje në një task force rajonale fokusuar në gjetjen e subjekteve me pa përputhshmëri; Krijimi i një lidhje telefonike për raportimin e parregullsive, të mashtrimit dhe incidenteve; Krijimi i një zyrë të trajnimit për të rritur kapacitetet e inspektorëve, si dhe për të lehtësuar punën e tyre me trajnimet; Krijimi i një programi të trajnimit profesional për inspektorë të punësuar rishtas; Raportimi i informacionit për veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror në bazë të të dhënave nga sistemi unik; Reduktimi i ndjeshëm i numrit të ditëve të inspektimit, si pasojë e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku.

Problematikat: Mungesë infrastrukture; Mungesa e zyrave për inspektorët; Mungesë e bazës materiale; Mungesë e logjistikës (automjete); Mungesa e një regjistri elektronik të subjekteve aktive të pajisura me Leje Mjedisore; Nevoja për përmirësim të listë verifikimeve të inspektimit; Nevoja për trajnim të inspektorëve të rinj për sistemin online “e-Inspektimi”.

Objektivat për vitin 2025: Zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore; Parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të shfrytëzimit pa kriter të burimeve ujore sipërfaqësore e nëntokësore, duke ruajtur shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore; Parandalimin e përkeqësimit dhe pakësimit të ndotjes së ujërave, duke ndikuar në përmirësimin e statusit të ujërave; Parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të brigjeve, duke ndikuar në mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së brigjeve; Krijimin e një baze të dhënash (regjistër elektronik) për të gjitha procedurat e kryera dhe dhënien e vendimeve përkatëse; Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji; Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit; Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike; Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj; Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit; Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut; Ndërgjegjësimin e publikut në vendimmarrjen mjedisore; Thjeshtimin e procedurave për biznesin.

8.2 Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB)

AKB, synon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke inspektuar mjediset dhe dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike, si dhe duke monitoruar rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare, në kuadër të respektimit të rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare.

AKB, ushtron funksionet e saj në zbatim të vkm-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore, në territoret, objektet e veprimtarisë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikën e Shqipërisë.


Trupa inspektuese e AKB-së, në nivel qendror ka në përbërje 20 inspektorë, ndërsa në 4 (katër) rajonet ka nga 1 (një) specialist, të cilët nuk kryejnë inspektime.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024, AKB, Drejtoria Qendrore ka realizuar 644 inspektime gjithsej, ku prej të cilave:

- ✓ 353 lidhur me kategorizimin e strukturave akomoduese dhe zbatimin e kriterëve dhe kushteve minimale sipas kategorisë;
- ✓ 2 inspektime agjenci udhëtimi dhe operatorë turistikë me licencën përkatëse;
- ✓ 219 inspektime për stacionet e plazhit;
- ✓ 2 inspektime për ushtrimin e veprimtarive me certifikatën për operatorët turistik detar;
- ✓ 30 inspektime të veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik.

Trupa inspektuese, gjatë vitit 2024, ka marrë gjithsej 190 masa administrative, nga të cilat 56 gjoba dhe 134 paralajmërime. Vlera në lekë masave administrative, gjobë të vendosura është 10.890.000 lekë. Numri i gjobave të arkëtuara për vitin 2024 është 18 dhe vlera e tyre është 1.120.000 lekë

Grafiku më poshtë, paraqet inspektimet e realizuara gjatë vitit 2024, sipas fushë veprimtarisë dhe masat administrative përkatëse të marra nga trupa inspektuese e AKB-së.



Për vitin 2024, pranë Komisionit të Ankimit në AKB janë depozituar dhe shqyrtuar 13 ankime administrative, nga të cilat:

- ✓ 4 masa administrative (gjobë) janë rrëzuar;
- ✓ 8 masa administrative (gjobë) janë lënë në fuqi;
- ✓ 1 është në pritje të afatit për Komisionin e Ankimit.

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, nuk rezulton të ketë ankime për vitin 2024.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: AKB realizon veprimtarinë inspektuese nëpërmjet pajisjes portabël tablet, në bazë të Programit Vjetor të Inspektimeve, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave, dakordësuar nga Inspektorati Qendror dhe të miratuar nga autoriteti përgjegjës; Veprimtaria inspektuese mujore mbështetet në Programet Mujore, të hartuar me listë subjektsh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuar dhe hartuar me bazë risku, por jo për çdo muaj; Inspektimet e ushtruara nga AKB kryen me Autorizim dhe me njoftim; Dokumentet standarde të inspektimit plotësohen në tërësinë e tyre dhe kryesisht në mënyrë të saktë; Procedura inspektuese realizohet konform ligjit nr. 10433/2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

Arritjet: Rritja e zbatueshmërisë së kriterëve ligjorë gjatë ushtrimit të aktivitetit në sektorin e hotelarisë (strukturave akomoduese) si rezultat i inspektimeve për përmbushjen e kriterëve të detyrueshme për secilën kategori, duke përmirësuar rritjen e standardeve për këtë sektor të rëndësishëm; Rritja e zbatueshmërisë së kriterëve ligjorë gjatë ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari turistike si stacionet e plazhit, nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2024 dhe bashkëpunimi me organet kompetente për lirim të hapësirave publike duke adresuar rastet; Rritja e zbatueshmërisë së kriterëve ligjorë gjatë ushtrimit të aktivitetit të operatorëve detarë dhe udhërrëfyes turistikë, nëpërmjet inspektimeve; Angazhimi dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për përditësimin e ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar.

Problematikat: Nevoja për përmirësim të logjistikës, duke sjellë si nevojë shtimin e mjeteve të transportit për trupat inspektuese, me qëllim realizimin e planit të inspektimit; Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB; Nevoja për përmirësime procedurale për udhërrëfyesin turistik të huaj, duke qenë se në sistemin “e-Inspektimi” të dhënat gjenerohen sipas regjistrimit të gjendjes civile, është e pamundur krijimi i çështjes, si dhe problem në ekzekutimin e masave administrative për udhërrëfyesin turistik të huaj.

Objektivat për vitin 2025: Kryerja e inspektimeve për kontrollin e kriterëve ligjorë nga subjektet në lidhje me fushat që janë në fokusin e punës së drejtorisë; Informimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve rreth ndryshimeve ligjorë të ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar; Mbarëvajtja e sezonit turistik nëpërmjet kontrollit të zbatimit të kushteve dhe kriterëve në stacionet e plazhit dhe aktivitetet e turizmit detar, përgjatë gjithë zonave bregujore; Hartimi i metodologjisë së riskut për subjektet që veprojnë në fushën e agjencive dhe operatorëve turistikë, strukturave akomoduese, udhërrëfyesve turistikë, stacioneve të plazhit dhe operatorëve të turizmit detar, duke u nisur nga rezultatet e inspektimeve të mëparshme dhe përfshirja e tyre në planin e punës për 2025.

8.3 Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP)

Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Sektori i Inspektimit ka si mision kontrollin për respektimin e legjisllacionit në fushën e pyjeve dhe zhvillon veprimtarinë inspektuese në bazë të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, si dhe vkm nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.

AKP është e organizuar në:

1. Nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë Qendrore
2. Në nivel rajonal, në 4 rajone (të cilat nuk janë krijuar).

AKP kryen aktivitetin inspektues në fushën e mbrojtjes së pyjeve. AKP kontrollon dhe monitoron zbatimin e ligjshmërisë së kontratave të bashkive dhe AKZM, urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrit të Territorit dhe Mjedisit, si dhe zbatimin e tyre. Inspekton zbatimin e lejeve licencave dhe kërkesave ligjore nga ana e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar.

AKP, gjatë vitit 2024, filloi të kryej inspektimet online nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi” dhe evidentoi në sistemin “e-Inspektimi”, kapacitetet e nevojshme për inspektimet online.

AKP, nga 12 inspektime të kryera gjithsej, vetëm në një procedurë inspektimi është realizuar dokumentacioni me tabletë. Gjithashtu, nga sektori i inspektimit në AKP janë vendosur 4 masa administrative gjobë, si dhe 1 paralajmërim.

Mbikëqyrja online nga sistemi “e-Inspektimi”: Procedura e inspektimit e ndjekur nga AKP kryhet me dokumente inspektimi, në përputhje me ligjin nr. 10433/2011, Procedura e

inspektimit nuk kryhet me tableta inspektimi sipas Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm; Në lidhje me mosnjohimin e Autorizimit të inspektimit, nuk njoftohet autorizimi, por nuk bashkëngjiten dokumentet e inicimit të procedurës inspektuese; Në Autorizimin e inspektimit nuk përcaktohet objekti i saktë i inspektimit, për të cilën kryhet procedura inspektuese, në të gjitha rastet.

Arritjet: Gjatë vitit 2024, AKP plotësoi të gjithë procedurën ligjore të inspektimit me dokumentet standarde dhe listë verifikime. Po kështu procedura inspektuese u implementua në sistemin edhe për inspektoratet vendore të pyjeve.

Problematika: Inspektorët e AKP të marrin të dhëna të plota gjatë procedurës së inspektimit, për të argumentuar më saktë, si rastet e shkeljeve të konstatuara, ashtu edhe ato të rregullta. Të evidentohet çdo veprim i kryer gjatë procedurës inspektuese; Autorizimi i inspektimit të plotësohet sipas objekteve të inspektimit dhe të përshkruhet më qartë objekti i inspektimit, për çdo procedurë inspektuese, si dhe të bashkëngjitet dokumenti i inicimit të procedurës inspektuese; Procedura inspektuese të kryhet me tableta inspektimi dhe pranë subjektit të inspektimit.

Objektivat për vitin 2025: Kryerja e të gjitha procedurave inspektuese në fushën e pyjeve me proces online, edhe për inspektoratet vendore të pyjeve.

VII. Raportimi i veprimtarisë për inspektoratet vendore

Përgjatë vitit 2024, Inspektorati Qendror në bashkëpunim me AKP dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligji i qeverisjes vendore nr. 139/2015, “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", ka realizuar trajnimin e 99 inspektorëve vendorë për fushën e pyjeve të 26 Bashkive, për kryerjen e inspektimeve online për fushën e pyjeve nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, me dokumente standarde të inspektimit dhe listë-verifikimi;

Gjithashtu, Inspektorati Qendror, në zbatim të nenit 16, të ligjit për inspektimin mban dhe përditëson Regjistrin e Inspektorëve shtetërorë/vendorë në detyrë dhe për këtë vit që kaloi disa nga njësitë e qeverisjes vendore nuk dhanë informacion lidhur me lëvizjen e burimeve njerëzore në fushat e inspektimit që mbulon secila bashki.

VIII. Raport Monitorimi i Buxhetit për vitin 2024 për Inspektoratin Qendror

Në zbatim të ligjit nr. 97/ 2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë, 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Inspektoratit Qendror është miratuar plani i buxhetit prej **59.441.000 lekë**, i detajuar, si më poshtë vijon:

Në /lekë

Llog.ekonomike	pershkrimi	Plan 2024
llog. 600	Paga	31 034 000
llog. 601	Sig.shoq punedh	5 307 000
llog. 602	Shpenzime operative	16 000 000
llog. 606	Ndihma ekonomike	100 000
llog. 231	Shpenzime kapitale	7 000 000
	TOTALI	59 441 000

Me Aktin Normativ nr. 3, datë 28.08.2024, plani i buxhetit të vitit 2024, u shtua në vlerën 6 000 000 lekë për llogarinë ekonomike 602, dhe me shkresë nr.17605/54 prot., datë, 15.01.2025, nga Ministria e Financave, u shtua në vlerën 30.000 lekë, për llogarinë ekonomike 606.

Sa më sipër, plani i rishikuar i buxhetit të vitit 2024, është 65.471.000 lekë, i detajuar si më poshtë vijon:

Në /lekë

Llog.ekonomike	Përshkrimi	Plan 2024
llog. 600	Paga	31 034 000
llog. 601	Sig.shoq punedh	5 307 000
llog. 602	Shpenzime operative	22 000 000
llog. 606	Ndihma ekonomike	130 000
llog. 231	Shpenzime kapitale	7 000 000
	TOTALI	65 471 000

Gjatë vitit 2024, IQ ka realizuar buxhetin në vlerën **61.659.904 lekë** nga totali i akorduar prej **65.471.000 lekë** ose **94.2 %**, të fondit të planifikuar të rishikuar vjetor 2024, detajuar sipas tabelës më poshtë:

Në /lekë

Llog.ekonomike	Përshkrimi	Buxheti Vjetor Plan i Viti 2024	Fakti progresiv vjetor 2024	Realizimi buxhetor vjetor 2024/%
llog. 600	Paga	31 034 000	28 136 162	90.7 %
llog. 601	Sig.shoq punëdh	5 307 000	4 409 567	83.1 %
llog. 602	Shpenzime operative	22 000 000	22 000 000	100 %
llog. 606	Ndihma ekonomike	130 000	128 700	99.2 %
llog. 231	Shpenzime kapitale	7 000 000	6 985 475	99.8 %
	TOTALI	65 471 000	61 659 904	94.2 %

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (llog. 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me vkm nr.39, datë 12.02.2019, me 21punonjës.

Për gjatë vitit 2024, numri i punonjësve faktik ishte 18 punonjës, nga 21 punonjës sipas strukturës. Për këtë arsye:

- ✓ Nga fondi i pagave (llog. 600), i akorduar prej 31.034.000 lekë për vitin 2024, është realizuar në vlerën 28.136.162 lekë, ose në masën 90.7 %, diferenca e mbetur është 2.897.838 lekë.
- ✓ Nga fondi i Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore Punëdhënës (llog. 601), i akorduar prej 5.307.000 lekë për vitin 2024, është reaalizuar në vlerën 4.409.567 lekë, ose në masën 83.1 %, diferenca e mbetur është 897.433 lekë.

Fondi për shpenzime operative dhe ndihma ekonomike (llog. 602, 606), është realizuar në zbatim të legjislacionit në fuqi, si edhe të udhëzimit plotësues nr. 01, datë, 24.01.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”.

1. Plani i buxhetit të vitit 2024, për shpenzime operative (llog.602) ishte 22.000.000 lekë, dhe u realizua 100%. Në fillim të vitit, plani i buxhetit të vitit 2024, ishte 16.000.000 lekë, dhe me Aktin Normativ nr. 3, datë 28.08.2024, plani i buxhetit të vitit 2024, u shtua në vlerën 6.000.000 lekë, me kërkesën e dërguar nga Inspektorati Qendror, në Ministrinë e Financave, me nr. 254 prot., datë 30.04.2024, për fonde shtesë për shlyerjen e detyrimit të mbetur të vendimit gjyqësor. Kjo për arsye se Inspektorati Qendror ishte në kushtet e vendosjes së sekuestros konservative nga Përmbaruesi

Gjyqësor Privat, me shkresë nr. 316 prot., datë 18.03.2024, si edhe nga Dega e Thesarit Tiranë me shkresë nr. 2035 prot., datë 28.03.2024, lidhur me detyrimin e mbetur të Vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit Tirane, nr. 34, datë, 26.01.2023, për punonjës in Lezan Gjyla (në vlerën 8.349.686 lekë), dhe fondi i buxhetit të vitit 2024, për shpenzime operative (llog.602), ishte i pajftueshëm në mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe angazhimeve të Inspektoratit Qendror, në kuadër të Reformës së madhe në Inspektim në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 242, datë 29.12.2023, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për riorganizimin e inspektorateve", që u finalizua me ligjin e ri, nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë".

2. Plani i buxhetit të vitit 2024 për Ndhim ekonomik (llog. Ekonomik 606), ishte 130.000 lekë, dhe u realizua në vlerën 128 700 lekë, ose 99.2%. Në fillim të vitit fondi ishte 100.000 lekë, miratuar me ligjin e buxhetit 2024. Bazuar në vkm nr. 846/2014, "Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore", plani i buxhetit të vitit 2024, u shtua në vlerën 30.000 lekë për llogarinë ekonomik 606, me kërkesë nga Inspektorati Qendror nr. 621 prot., datë 30.12.2024, për përdorimin e fondit të vecantë, miratuar nga Ministria e Financave me shkresë nr.17605/54 prot., datë. 15.01.2025.

Fondi për shpenzime kapitale (llog. ekonomik 231). Për vitin 2024, plani i buxhetit për shpenzime kapitale, të trupëzuara, me financim të brendshëm, është akorduar në vlerën

7.000.000 lekë dhe është realizuar në vlerën 61.659.904 lekë, ose 94.2 %, në total, dhe përbëhet nga tre kode projekti:

- 3.400.000 lekë, akorduar për blerje pajisje hardware, (tableta), me kod projekti 18AO601, për inspektim online për Inspektoratet Shtetërore. Ky fond i akorduar për "Blerje tableta dhe zhvillimi i tyre në sistem", u prokurua nga AKSHI, sipas specifikimeve të publikuara dhe të miratuara. Procedura e prokurimit u realizua me marrëveshje kuadër nr. 2204 prot., datë, 05.05.2023 dhe me shkresën nr. 3747 prot., datë, 02.08.2024 AKSHI dërgoi autorizimin për lidhje Kontrate për Inspektoratin Qendror me kompaninë fituese Introvus Solutions shp.k. Kontrata u lidh me nr.183/3prot., datë, 20.09.2024, si dhe u realizua në vlerën 3.150.000 lekë.
- Diferenca e fondit prej 250.000 lekë, nga realizimi i kontratës për "Blerje Tableta dhe zhvillimi i tyre në sistem", u rialokua me kod projekti të ri M870092 (pakësim nga kodi 18AO601, shtim M870092 në vlerën 250.000 lekë brenda fondit 3.400.000 lekë), me kërkesën e Inspektoratit Qendror, me shkresë nr. 12923/1 prot., datë, 07.10.2024, nga Ministria e Financave, për likuidimin total të detyrimit të prapambetur me kompaninë "IkubINFO" shpk, për Kontratën nr. 5549 Prot., datë 15.10.2018, "Mirëmbajtja e sistemit e-Inspektimi për IQ", fatura nr. 285048125, data 16.12.2019, në vlerën 235. 875 lekë.

- 3.600.000 lekë, akorduar për "Blerje 1(një) makinë elektrike tip fuoristradë", me kod projekti M870194. Procedura e prokurimit u realizua nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara, konform specifikimeve teknike dhe dokumentacioni përkatës, si dhe dërgoi autorizimin për lidhje Kontrate për Inspektoratin Qendror me kompaninë fituese Mektrin Motors shpk. Kontrata u lidh me nr. 494 prot., datë, 17.10.2024 dhe u realizua në vlerën 3.290.000 lekë. Me diferencën e fondit prej 310.000 lekë, nga realizimi i kontratës, me të njëjtin kod projekti, u realizua prokurimi i një karikuesi (kullë karikimi) për makinën elektrike, në vlerën 309.600 lekë.

Në realizimin e zërave buxhetore të planifikuara për vitin 2024, IQ-ja ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.10433 datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe legjislacionin administrativo-financiar shqiptar të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit".

IX. KONKLUZIONE

Inspektorati Qendror, me të gjitha parashtimet e mësipërme konkludon se procesi inspektues ka përmirësime të kënaqshme, të cilat lidhen me miratimin e ligjit të ri të inspektimit, me kryerjen e inspektimeve online, duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në marrjen e vendimeve përfundimtare të inspektimit, si dhe duke ulur barrën administrative ndaj biznesit.

Për sa më sipër në këtë raport konkludojmë se:

- ✓ Miratimi i ligjit të ri për inspektimin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili është një ligj horizontal, rregullator ku normon procedurën e inspektimit për të gjitha inspektoratet në nivel qendror dhe vendor që janë në fushë zbatimin e tij, rekrutimin, disiplinën e inspektorëve dhe ankimin administrativ, me qëllim unifikimin dhe konsolidimin e veprimtarisë së sistemit të inspektimeve dhe përmirësimin e klimës ndaj biznesit.
- ✓ 17 inspektorate shtetërore realizojnë veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet portalit unik “*e-Inspektimi*”, sipas ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, vkm nr. 696/2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, ligjeve sektoriale, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi që rregullojnë fushat e inspektimit.
- ✓ Inspektorati Qendror në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, mbështeti nga ana metodologjike 26 Bashki, për kryerjen e inspektimeve online për fushën e pyjeve nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, me dokumente standarde të inspektimit dhe listë-verifikimi.
- ✓ Procesi inspektues në disa prej inspektorateve shtetërore/drejtoreve rajonale vazhdon përsëri të realizohet nëpërmjet kiteve portabël dhe jo tabletave, gjë e cila e bën të pamundur verifikimin nëse dokumentacioni inspektues është mbajtur pranë dhe në prani të subjektit të inspektimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 45, të ligjit për inspektimit, si dhe germës c, pika 2 e kreut I, të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e Rregullores, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, i ndryshuar.
- ✓ Vazhdon akoma të ketë mospërputhje midis listës së subjekteve të programuara nga ana e inspektorateve shtetërore dhe të gjeneruara në sistemin “*e-Inspektimi*”, me ato të dërguara me shkresë pranë Inspektoratit Qendror për mendim këshillimor.
- ✓ Për rritjen e performancës së inspektorateve shtetërore, gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese online, janë trajnuar dhe ritrajnuar 371 inspektorë shtetërorë dhe 99 inspektorë vendorë.
- ✓ Në sistemin “*e-Inspektimi*”, shumica e inspektorateve shtetërore nuk pasqyrojnë ecurinë e masës administrative, (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në

kundërshtim të pikës 10, të Kreut XIII, të vkm nr. 696/2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”, kjo mangësi e përsëritur dhe e shprehur në raportet e mëparshme të inspektimit, konsiderohet si mungesë përgjegjshmërie e autoriteteve përgjegjëse dhe kërkon zbatim të menjëhershëm.

- ✓ Dokumentet standarde të inspektimit si: Autorizim, listë-verifikimi, procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar kanë mangësi në plotësimin e tyre dhe në disa raste nuk ka shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara.
- ✓ Akti administrativ “Autorizim”, ka raste ku lëshohet për një kohëzgjatje të madhe disa ditore për kryerjen e inspektimit, Arsytimi i kërkesës për shtyrje të autorizimit nuk është në përputhje me pikën 2, të nenin 29 dhe kohëzgjatja e kërkuar për shtyrje është më e madhe se kohëzgjatja fillestare; Dokumenti për njoftimin e Autorizimit, subjektit të inspektimit nuk ngarkohet gjithmonë në sistemin “e-Inspektimi”, në kundërshtim me Urdhrin nr. 25, datë 10.08.2018, “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregull administrativ”, i ndryshuar.
- ✓ Akti administrativ “Procesverbal”, shpesh herë nuk pasqyron në mënyrë të detajuar konstatimet apo shkeljet e evidentuara gjatë veprimtarisë inspektuese, duke mos zbatuar nenin 45, ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- ✓ Akti administrativ “listë-verifikimi”, në disa raste nuk plotësohet saktë apo në të gjitha rubrikat e saj, duke mos pasqyruar konstatimet gjatë procedurës së inspektimit apo nuk është nënshkruar nga subjekti i inspektimit, për inspektimet e realizuara me tablet ose ka shumë raste kur nuk vlerësohet me “po”, “jo” apo “N/A”, ndërkohë që argumentohet arsyeja e plotësimit ose mosplotësimit të kërkesës ligjore etj.
- ✓ U realizua integrimi me portalin “e-Albania”, mbi postimin e dokumenteve të procedurës së inspektimit në llogarinë e subjektit në “e-Albania”.
- ✓ U realizua integrimi me e-Sign, duke implemtuar nënshkrimin elektronik nga rolet kryeinspektor shtetërorë/rajonat për dokumentin “Autorizim”.
- ✓ Janë në proces integrimi vulosja elektronike për rolet kryeinspektor shtetërorë/rajonat, si dhe përshtatja e sistemit “e-Inspektimi”, për të pritë ankimet e subjekteve për vendimet përfundimtare të inspektimit nga portali “e-Albania”.
- ✓ Disa prej ISH, nuk përditësuan përsëri listë-verifikimet sipas formatit standard të miratuar nga IQ, sipas Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, i ndryshuar, e cila ndikoi edhe në mos funksionimin e modulit të riskut.
- ✓ Për rritjen profesionale të inspektorëve, Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore, ku marrëdhënia e punës rregullohet sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, ka bërë vlerësimin dhe testimin fillestar për 67 inspektorë në periudhe prove.

- ✓ Vazhdon të mos kryejnë inspekte online Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në fushën e ndërtimeve të paligjshme dhe produkteve të ndërtimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për Sektorin PIK, gjë e cila bie në kundërshtim me ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, por vijon procesi inspektues me dokumente të parashtypura dhe me numër serial.
- ✓ Regjistri Kombëtar i inspektorëve shtetërorë është mbajtur dhe përditësuar sipas Kreut V, të vkm nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, si dhe janë shpërndarë 247 karta të inspektorëve.
- ✓ Në kuadër të reformës në inspekte, për të shkëmbyer informacione dhe ndarë eksperiencë në fushën e inspektimit u realizua vizitë studimore në Lubjanë, Slloveni, është zhvilluar takim pune me Inspektoratin e Përgjithshëm të Kroacisë, me Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, korrespondenca e vazhdueshme me ekspertë të OECD.

XI. REKOMANDIME

Inspektorati Qendror, për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese për vitin 2025, rekomandon sa vijon:

- ✓ Inspektorati Qendror në bashkëpunim me inspektoratet shtetërore dhe trupat e të tjera inspektuese, të fillojnë zbatimin e ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pas hyrjes në fuqi të tij.
- ✓ Të hartohet programi vjetor i inspektimit sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut, për të bërë të mundur parandalimin e rreziqeve që vijnë nga subjektet me rrezikshmëri të lartë, në zbatim të ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, sipas përcaktimeve të urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.
- ✓ Të dërgohet programi vjetor i inspektimit për dhënie mendimi pranë Inspektoratit Qendror brenda datës 15 tetor të vitit paraardhës, sipas afateve të përcaktuara në pikën 1, të kapitullit IV, të vkm nr. 696, datë, 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “*e-Inspektimi*”, si dhe të miratohet nga ministri përgjegjës në referencë të nenit pikës 3, të nenit 24, të ligjit 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- ✓ Inspektoratet shtetërore duhet të bëjnë kategorizimin e subjekteve me risk më të lartë, me qëllim identifikimin, parandalimin ose minimizimin e riskut, sipas përcaktimeve të urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.
- ✓ Të kryhet veprimtaria inspektuese online nëpërmjet tabletës edhe për ato inspektorate shtetërore/drejtori rajonale, të cilat ende nuk janë përdorues i saj, në mënyrë të tillë që të ndiqet gjurmueshmëria e procesit inspektues dhe dokumentet e gjeneruara në sistem të jenë të nënshkruara nga kryeinspektori, inspektorët dhe subjekti i inspektimit, në zbatim të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, i ndryshuar,
- ✓ Të vazhdojë procesi i kryerjes së inspektimeve të përbashkëta nën koordinimin e Inspektoratit Qendror, me qëllim zvogëlimin e kostos administrative ndaj subjekteve të inspektimit dhe rritjen e efektivitetit të inspektimeve.
- ✓ Subjektet e programuara të sjella me shkresë dhe dakordësuar nga Inspektorati Qendror, të përputhen me subjektet e programuara dhe gjeneruara në sistemin “*e-Inspektimi*”, sipas muajve përkatës, në zbatim të Kreut IV, të vkm nr. 696, datë 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Të vazhdojë njoftimi për subjektet e programuara, jo më vonë se 7 ditë para fillimit të

procedurës së inspektimit, si dhe të ngarkohet në sistem dokumenti i njoftimit, në zbatim të urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e Rregullores, “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, të ndryshuar, përveç rasteve kur parashikohen ndryshe nga ligji i posaçëm.

- ✓ Kur inspektimi është me njoftim paraprak, dosja e inspektimit duhet të shoqërohet me dokumentacion bashkëlidhur, për realizimin e njoftimit, sipas parashikimeve ligjore të pikës 1, të nenit 32, të ligjit për inspektimin dhe urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, i ndryshuar.
- ✓ Të përditësohen listë-verifikimet në varësi të ndryshimit të bazës ligjore sipas formatit standard të miratuar (Po/Jo/NA), në referencë të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, i ndryshuar, si dhe të bëhet formulimi i pyetjes në listë verifikim sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut.
- ✓ Të plotësohen të gjitha rubrikat dhe në mënyrë të saktë, të akteve administrative të inspektimit si: listë-verifikimi, procesverbal dhe vendim përfundimtar, ku të jepen shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara, si dhe të këshillohet subjekti i inspektimit për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore, me qëllim parandalimin e shkeljeve të tyre. Gjithashtu, të evidentohet saktë baza ligjore (*germa, neni, ligji përkatës*) e shkeljes së konstatuar dhe e masës administrative të marrë.
- ✓ Të plotësohet rubrika “kohëzgjatja e inspektimit”, në orë, orën e fillimit dhe mbarimit, në autorizim, procesverbal inspektimi dhe vendim përfundimtar, në zbatim të nenit 28, të ligjit nr. 10433/2011, për inspektimin.
- ✓ Procesverbali dhe listë verifikimi si pjesë integrale e tij, duhet të mbahen brenda kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim, në zbatim të pikës 1 dhe 4, të nenit 29, të ligjit për inspektimin, ku përcaktohet se “*Autorizimi është i vlefshëm vetëm për kohëzgjatjen e përcaktuar shprehimisht në të*”, ku për çdo veprim procedural të kryer jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar nuk prodhon asnjë pasojë juridike për subjektin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore inspektorin përkatës.
- ✓ Të dokumentohet sa më shumë të jetë e mundur veprimtaria inspektuese me dokumente justifikuese, si foto/video, referuar nenit 39, të ligjit nr. 10433/2011, të cilat duhet të ngarkohen në sistemin “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Procedura e inspektimit duhet të realizohet gjithmonë pranë, dhe në prani të subjektit objekt inspektimit në përputhje me pikën 2, të nenit 45, me germën a, të pikës 1, të nenit 33, si dhe germën f, të pikës 1, të nenit 28, të ligjit për inspektimin.
- ✓ Dokumenti për njoftimin e Autorizimit, subjektit të inspektimit, të administrohet, në sistemin “*e-Inspektimi*”, në zbatim të Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, të ndryshuar.

- ✓ Dokumenti “Vendimi Përfundimtar”, të pasqyrojë përshkrimin e bazës ligjore për kërkesën e shkelur apo përshkrimin e bazës ligjore të masës administrative përkatëse.
- ✓ Vendimi përfundimtar të merret brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektiv të inspektimit, duke respektuar të drejtën e subjektivit për kontestime, në përputhje me nenin 45 dhe 46 të ligjit për inspektimit, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji sektorial.
- ✓ Të dokumentohet dhe të administrohet në sistemin “e-Inspektimi”, marrja dijëni e subjektivit, lidhur me dokumentet e veprimtarisë inspektuese mbajtur në subjekt nga grupi i inspektimit: Listë Verifikim, Procesverbal Inspektimi dhe Vendim Përfundimtar, në përputhje me Urdhrin nr. 25, datë 10.08.2018, “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, i ndryshuar.
- ✓ Të pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në modulën “gjëbja”, për të gjitha ato inspektorate shtetërore/trupa të tjera inspektuese në zbatim të pikës 10, të Kreut XIII, të vkm nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”.
- ✓ Të vazhdojë bashkëpunimi dhe mbështetja për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për fushën e ndërtimit dhe për Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të cilët akoma nuk kryejnë inspektime online.
- ✓ Të dërgohet informacioni në kohë pranë Inspektoratit Qendror, për çdo emërim në detyrë ose për çdo lirim nga detyra të inspektorëve, sipas pikës 3 dhe 4, të Kreut V, të vkm nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, me qëllim përditësimin e Regjistrisë Kombëtare të inspektorëve shtetërorë/vendorë në detyrë.
- ✓ Të vazhdojë të mbështetet edhe veprimtaria inspektuese për inspektoratet vendore, me qëllim kryerjen e inspektimeve online në sistemin “e-Inspektimi”, edhe njësitë e qeverisjes vendore.
- ✓ Të përditësohen website-t e inspektorateve shtetërore dhe të publikohen akte administrative/broshura për subjektet, lidhur me procedurat e inspektimit, për të siguruar njohjen mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre.
- ✓ Të vazhdojë procesi informues sa më shumë të jetë e mundur nga ana e Inspektoratit Qendror dhe Inspektorateve Shtetërore për biznesin dhe qytetarët mbi ligjin e ri të inspektimit nr. 99/2024, për të qenë transparent dhe efektiv lidhur me detyrimet mbi zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.